



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 06/22
Rahovec, 20.06.2022

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e gjashtë (6) cila do të mbahet më **29 qershor 2022 (e mërkure)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 zonë kadastrale Mrasor;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00759-0 në zonën kadastrale Retijë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00377K-0, 00444K-0 dhe 02214K-0 në zonën kadastrale Xërxë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01830-0, zona kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P - 01830-0, zona kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik – P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e Pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publike;

14. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr. 306/22 i datës 29.04.2022 për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në Komunën e Rahovecit i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01-Nr. 334/22 të datës 31.05.2022;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 332/22 i datës 31.05.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale Krushë e Madhe
16. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;


KRYESUESI I KUVENDIT
Deftim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë (5) e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **31.05.2022**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Defrim Kafeqiu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm.

Të nderuar kuvendarë, për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komiteteve për Arsim dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.296/22, i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.295/22, i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak,
11. Raporti vjetor i punës së komitetit të auditimit për vitin 2021.

Arbër Zenuni - Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, i nderuar nënkryetar z. Fatmir Iska, drejtor te drejtorive, kolegë asamblistë dhe gjithë pranishmit ne sallë. Në emër të grupit të AAK-së i kemi për propozim dy pika: e para është shpallja në interes të përgjithshëm publik për parcelat P-715/1300502756/0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe. Me datë 23 (e shtune) kemi mbajtur një takim me qytetarët e Krushës së Madhe ku kanë qenë pranishëm edhe kolegë asamblistë, njëri prej tyre edhe z. Sejfullah Sejfullahu, ku bashkëbisedimi ishte në lidhje me projekt-propozimin për zonën që do të shpallet në interes të përgjithshëm nga komuna e Rahovecit. Zona e quajtur "Paca Paca" është në interes të komunitetit dhe qytetarëve të Krushës së Madhe dhe të gjitha bizneseve të cilat kanë shprehur interes që në të ardhmen të kenë një vend ku të investojnë. Pika e dytë: projekt-vendimi për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese në komunën e Rahovecit, parcela kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-715/1300501704/0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe në vendin e quajtur "Rasa Sprud" me sipërfaqe të përgjithshme 143.712 metra në katror, parcela tjetër sipas certifikatës së pronësisë me nr. P-715-130050274/0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe në po të njëjtin vend të quajtur "Rasa Sprud" me sipërfaqe të përgjithshme prej 381.960 metra në katror. Pra, janë tre parcela që përfshihen diku rreth 70ha që janë në interes për të gjithë ata që dëshirojnë të investojnë. Atëherë ne si grup i Aleancës kërkojmë nga ju që t'i fusim në rend dite këto dy pika dhe të kalojmë më tutje.

Kryesuesi – Faleminderit Arbër, nëse dikush prej asamblistëve ka nevojë për informata shtesë prej ndonjërit prej drejtorëve në lidhje me këto dy propozime të grupit të Aleancës, urdhëroni? Nëse jo, atëherë po i vendosim këto dy propozime...Drejtori e ka fjalën për informata shtesë rreth këtij propozimi.

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar asamblistë. Kemi provuar edhe bashkërisht me juve dhe me anëtarë të KPF-së dhe në mbledhjen e prillit që t'i fusim në rend dite këto dy pika, keni kërkuar informata shtesë, historiatin e këtyre parcelave. Drejtoria për gjeodezi, kadastrë dhe pronë ka bërë historiatin e këtyre tri parcelave, përfaqësuesit ligjorë të komunës kanë kërkuar prej gjykatës themelore në Gjakovë- nëndega në Rahovec informata nëse kemi konteste të hapura me këto parcela, përgjigja e tyre ishte që nuk ka konteste, nuk ka pretendues, nuk ka procedura të hapura në gjykatë. Këto tri parcela, dy parcela të komunës dhe një që është pronë shtetërore e Kosovës KK Rahovec –Ujërat, janë parcelë komunale prej vitit 50-të kur edhe është formuar kadastra përshtuese. Po kërkojmë prej juve për shpallje në interes të përgjithshëm, më pas prapë do të vijmë këtu që ta shihni projektin dhe që t'i ndajmë këto parcela, se cila parcelë do t'i takoj bizneseve, cila blegtorisë e cila bujqësisë. Kemi qenë në Krushë ashtu siç e tha edhe kuvendari Arbër Zenuni, jemi takuar me përfaqësues të zonës, të bizneseve, të asamblesë komunale të zonës atje dhe nuk kemi pas probleme, kemi biseduar më shumë për parkun në fshat se sa për këto hapësira. Kërkojmë prej juve që mos të vonohemi sepse jemi duke u përpjekur në qershor ta kemi Xërxën dhe më pas vazhdojmë me zona tjera aty ku kemi zona të lira.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, nënkryetarin, anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit këtu.

Konsideroj që ata që kanë kërkuar që këto pika të rendit të ditës të largohen t'a marrin fjalën dhe të japin sqarime rreth asaj që ka ndodh në debat aty, sa janë pajtuar qytetarët në mënyrë një pasqyrë pak më të qartë, në fakt kjo pikë është shtyrë pa nevojë, sipas meje çdo here kur kemi të bëjmë me interes të përgjithshëm, nuk ka nevojë të vijmë në këtë pikë që jemi tani. Drejtori kur tha që nuk kemi biseduar shumë për këtë çështje me qytetarët atje pak më shqetësoi sepse për këtë punë është mbajtur debati-konsultimi me qytetarë, sidoqoftë kërkoj sqarime shtesë e më pas dalim në votim, faleminderit.

Kryetari – Faleminderit kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, mediat, monitoruesit e kësaj mbledhjeje, mirëserdhe Fahrije Lushi. Ne kemi qenë në Krushë, kam qenë pjesë e takimit, dëshiroj t'a plotësoj pak drejtorin e drejtorisë dhe Arbërin. Është prezantuar projekti me harta, skica dhe historiatin para qytetarëve të pranishëm. Është shumë e vërtetë që takimi ka marrë një dimension tjetër, sepse qytetarët janë interesuar edhe rreth objekteve që janë në qendër të Krushës. Sipas historiatit që e posedojmë ne, gjithçka është pastër

dhe kemi ardh në konkluzioni që është edhe detyrim ligjor nëse hasim diçka në proces në të ardhmen, ne të drejtën mbi pronën private-publike me ligj e kemi të rregulluar dhe po kërkojmë mbrojtjen e asaj parcele dhe çdo parcelë tjetër me vendim të kuvendit të komunës, duke shpallur në interes të përgjithshëm dhe pasta të fillojmë debatet tjera për hartimin e projekteve ideore me kuvendit të komunës duke vendosur se çka të bëhet tutje. Unë besoj që në kuadër të detyrimit që kemi, propozimi është me vend dhe gjithçka çka ndodh në këto zona atëherë përsëri kuvendi i komunës si institucioni që i jep vulën dhe në momentin që krijohet ajo zonë apo ajo hapësirë për biznese ju cakton afatin kohëzgjatjen sa mundet m ju dhanë dhe kuvendi i komunës është ai që vendos krejt në fund. Po ashtu kanë qenë edhe anëtarët e komitetit për Politike dhe Financa por jo të gjithë si Sejfullah Sejfullahu nga Krusha e Madhe, Sinan Kryeziu nga Xerxa, Ilir Pallqa nga Rahoveci, Rumir Zhuniqi nga Fortesa dhe Besmire Bytyqi nga Opterusha. Kështu që unë po besoj që shtyrja ka ndodhur me mirëkuptim dhe ne kemi marr disa veprime dhe kemi obliguar drejtorinë që me nxjerr krejt çka ka aty dhe ka dal gjithçka pastër. E vërteta është që me vendimin e kuvendit të komunës që ne mundemi me ardh në një situatë me të favorshme ligjore por edhe me të favorshme me mundësi në të ardhmen dhe në momentin që bëjmë buxhet dhe bëjmë përgatitjen e zonës dhe aftësimin e atyre parcelave me infrastrukturë, përsëri vendos kuvendi i komunës se çfarë do të ndodhë, pasi në ende nuk e kemi projektin ideor dhe as projektin kryesor dhe as nuk e kemi parcializimin e zonës. Pasi krejt këto në proces bëhen dhe po besoj që kuvendi i komunës ka me pas një rol vendimtar dhe do të jep legalitetin në situatën e mëvonshme në një situatë tjetër kurdo që jepen në shfrytëzim ato edhe për kohëzgjatjen dhe plot tema tjera. Kështu që unë jam ihtar që me shpall parcela me interes të përgjithshëm kudo që ka në komunën e Rahovecit, pasi e para që me këtë vendim në mbrojmë pronën tonë, pastaj e dyta ne japim mundësi që me administru me pronën tonë dhe çka po dëshirojmë me bo me atë pronë dhe çfarë vizioni kemi si institucione të zgjedhura për ato prona që i mbrojmë me vendim të kuvendit. Kështu që do të ishte mirë me votu dhe gjithashtu e pres edhe komentën e asamblistit Sejfullah Sejfullahu dhe po besoj që ka qenë në një vështirësi për shkak të paqartësive të cilat jo rrallë krijohen por sigurisht se e ka kuptu se edhe ai kanë të gjithë ata qytetare që kanë marr pjesë i kanë dokumentet dhe historiatin e asaj zone kështu që e kanë pa se aty gjithçka është komunës pavarësisht se pretendimet tona janë legjitime që kanë mundur me qenë në kohërat e hershme me plot situata të cilat jemi të vetëdijshëm sepse kemi kaluar në procese jashtëzakonisht të vështira edhe historike. Por nga vitet e 50-ta sipas kadastrit tekstual përshtatës, ne jemi në rregull me ato prona dhe uroj që të jemi në rregull madje edhe me prona tjera që do të kemi të lira ndoshta në Celin, Xerxe, në qytet apo edhe kudo neper vendbanimet tona.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, drejtor, asamblistë, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Është shumë vërtet që ndoshta debati është shterur sipas juve, por po ju përgjigjem juve Rasim Fazliu dhe juve Arbër Zenuni. Në fillim kur ka ardh kjo, kam kërkuar me mirëkuptim që me shty për shkak të paqartësive dhe presionit që kam pasur. Çuditërisht nuk po di me bo politike por sigurisht që ma merr mendja që edhe ty Berat Duraku e po ashtu edhe ty Arbër Zenuni që edhe juve ju kanë bërë presion por që ju po mbani në vete mirëpo unë po e shprehi haptas që me kanë bërë presion dhe për një gjë të tillë publikisht edhe të gjithë asamblistët ju kam falënderuar për shtyrjen. Kur jeni ardh herën e parë në takim, jemi dakorduar që me sjellë edhe dokumentin e kadastrit por në ndërkohë ju pata thënë që para se me u mbajt takimi i dytë dhe para se me shku në Komitetin për Politike dhe Financa kemi pas mosmarrëveshje dhe keni ardh edhe herën tjetër. Arbri e arsyetoj atë që e tha por të paktën u deshtë me bisedua me mua pasi të dytë jemi po nga i njëjti vend, pasi edhe shumë me herët kemi pasur biseda mes vete dhe i kemi shqyrtuar këtë temë dhe jemi dakorduar që kemi shumë telashe për këtë çështje mirëpo sido që të jet është propozimi i tij. Po ashtu është e vërtet se kemi bërë debat edhe pse në raport me mu jemi marr vesh se nuk kemi asnjë lloj problemi apo vërejtje mirëpo me ata shfrytëzues nuk jemi marr vesh pasi me tepër kemi folur për shitoren dhe lokalit që punon si berber pasi që debati eskaloj ashtu dhe problemi është se nuk e di se çka me nxitim ajo punë pasi unë si Sefë edhe njëherë ju falënderoj për angazhimin dhe gatishmërinë që keni ardh edhe keni dëshmuar gjithçka, por përsëri kam presion rreth kësaj edhe pse ju thoni që e keni rregulluar mirëpo disa prej

tyre me janë ankuar dhe tash nuk e di tash a jeni pajtuar që dikujt me ju prekë parcela dhe dikujt me ju prekë parcela dhe nëse behet ajo do te behet për te gjithë dhe e di që komuna ka me shpall zone me interes te përgjithshëm pasi aty veç bari me mbjell do te behet me bukur se sa që është tani dhe nuk dyshoj që ka ndonjë prapavijë pasi që nëse ka atëherë secili do ti bart pasojat por që duhen sqaruar gjërat. Kështu që nëse e votoj unë këtë pike te rendit te ditës atëherë ata njerëz do te thonë që asamblisti i Krushes Sejfullah Sejfullahu ka votuar për me shit dhe me ja dhanë komunës mirëpo nëse nuk e votoj sikur e kam një bindje se atje do te behet bukur diçka sigurisht se brenda periudhës 10 vjeçare do te behet me bukur se sa që është tani dhe do te më mbrehë ndërgjegjja që unë nuk e kam votuar, kështu që unë si Sefë do te abstenoj, kështu që ju them se ju nuk jeni marr me ata njerëz por sinqerisht ju them se nuk jam duke u shqetësuar se kush kërcënon apo nuk kërcënon, pasi nuk mund te kërkoj nga asamblistët që me votu apo mos me votu, pasi secili i din punët e veta dhe unë e shpreha qëndrimin tim dhe ju falënderoj që keni qenë dy herë megjithëse ka vërejtje edhe ajo pasi kane paralajmëruar disa orë me përpara mirëpo vetëm disa vishën ne takim dhe ndoshta pikërisht ata që vinin nuk kishin te bënin me ato prona dhe sigurisht që me ka ardh keq që ka eskalu krejt për diçka tjetër, por sido që të jetë nuk kam ndonjë vërejtje konkrete edhe pse jeni përgjigjur ne pyetjet e mira që nga fillimi mirëpo kjo është paksa me nxitim dhe për këtë jam shume i shqetësuar për këtë për rikthimin e qeverisë për me vazhdu me privatizim edhe mua me ka shqetësuar ky problem sinqerisht kështu që le te mbetet përgjegjësi e pjesës juridike.

Kryetari – E mbajta ne mendje krejt fjalimin e Sefës por edhe këtë te fundit ku tha që është shqetësuese që qeveria e Kosovës e ka aktivizuar çështjen e privatizimit dhe kanë fillu edhe me u lansu prona dhe me u shpall projekte. Pra është një standard që ne njohim pasi ekziston rreziku potencial që pronat e komunës e sidomos ajo prona e ujërave. Kështu që me u interesua dikush ne kemi te dhëna edhe te tjera te cilat besoj që edhe Sefa edhe gjithë te tjerët e kuptojnë, pasi ekziston rreziku që një ditë me qenë para aktit te kryer pasi AKP-ja pasi veç e njofton komunën dhe nuk e vet hiq e sidomos për prona që ne njëfarë mënyre menaxhohen nga AKP-ja siç ka edhe nga agjencioni pyjor te Kosovës që edhe aty munden me u privatizu dhe munden me ju dhanë ne shfrytëzim. Pra ne njëfarë mënyrë vendimi i kuvendit te komunës e mbron pronën edhe nga pretenduesit e sotëm që mund te kenë pretendime legjitime por jo te faktume por edhe nga privatizuesit potencial te nesërme pa pasur nevojë hiq me u aktivizu AKP-ja pasi që ne jemi dëshmitar te plotë pronave që na kanë ikur pasi kanë gjetur te tjerët hapësira ligjore dhe i kanë bërë pronat komunale dhe një prej tyre është ne fshatin tim Ratkoc pikërisht ne vendin ku është tregu tash është pronë private edhe pse ka qenë pronë e pastër pronë komunale dhe ne plot vende tjera dhe pa pasur nevojë AKP-ka ata kanë gjetur avokat dhe plot dëshmitar pasi ata lëndë e disponoj ne tërësi dhe sot ajo është pronë private. Kurse sa i takon shfrytëzuesve që nuk e kanë verdiktin e organeve kompetente cila do qofshin ato, ne do te ju ofrojmë zgjidhje pasi që ligji ka paraparë zgjidhje edhe për ata. Por ndoshta ka nevojë me pa mundësinë që a do te ishte mirë që ne planin afatshkurtër me emergjencë organet tona me vepru ndaj atyre që ndoshta nuk e kanë një pëlqim punë per me operu ne prona komunale, pasi që kemi aso situata dhe mund te kemi ne ato parcela për te cilat folëm dhe unë e di saktë se kush janë pasi janë edhe miçë tanë por mos te harrojmë se e kemi edhe një situatë edhe ne qytet tek stacioni i autobusëve ne Rahovec që megjithatë është gjetur mënyra që ajo pronë me u liru prej shfrytëzuesve që nuk e kanë një verdikt legal pra një vendim apo pëlqim dhe tash ajo pronë është pastruar. Kështu që tash e kujt do te behet ajo pronë dhe kujt do ti mbetet pasi ne kemi bërë një veprim te mirë pasi nuk e kemi pasur te lehte pasi është pikërisht ne qendër dhe dikush ka oper aty si biznes dhe nuk dëshirojmë me fol me gjuhen e vrazhdë pasi e kemi gjuhen e ligjit dhe inspektorati vepron pikërisht për ato punë por nuk po besoj që bën mirë dikush nëse ne nuk marrim angazhim te nxjerrim një verdikt bashke si kuvend i komunës, pasi vërtet unë nuk kam te drejtë vote sepse do te votoja me plot përgjegjësi pasi e di nga përvoja ime si kryetar i komunës që na ka ndodhur neve me prona neper komuna edhe gjithë Kosovës sigurisht. Prandaj ju kisha lutur që ta mbrojmë me vendim tonin dhe prona mbetet e jona dhe me pastaj çfarë do te bëjmë me ata që nuk e kanë pëlqimin me operu tash apo që kanë operu deri tash por nuk duhet te

harrojmë që kemi obligim me ndërmarr edhe veprime te natyrave tjera sepse e mbrojmë prej keq shfrytëzimit apo shfrytëzimi i paligjshëm një pronë që është e jona. Unë po besoj që janë një apo dy njerëz që janë miçë tanë dhe që është e kuptueshme që ka një presion dhe unë e kam inqizu gjendjen bukur thellë dhe e disponojmë krejt materialin dhe ku me marr edhe ne me pas dokumente që e sfidojnë vendimin e kuvendit komunal pra dokumente te pronarëve privat dhe sigurisht se ne do te dorëzohemi sepse jemi te detyruar dhe te obliguar ligjërisht. Pra është mirë që ka nisur me Krushen dhe ne po shfrytëzojmë me gjet prona nëse kemi ne Xërxe për shkak se kërkojnë hapësira për biznese dhe po ashtu ne periferi te qytetit dhe jemi duke shikuar mundësin që me ja marr ne menaxhim edhe AKP-së pasi ju kemi drejtuar me shkresa dhe ju e dini edhe për pronën që ka vendos ky kuvend te shkolla Sadedin Hajda pastaj ju kemi drejtuar edhe agjencionit pyjor te qendra e regjistrimit civil tek ndërtesa e KRU-Gjakova, pra ne jemi te interesuar që me pas sa me shume prona me pas ne menaxhim për shkak se po na duhen për zhvillime pozitive ne këtë vend kurse a na japin apo jo por detyra jonë është edhe me vendim te kuvendit te komunës që ta dini që ne atë parcelën që ka pëlqim apo menaxhim bashkësia e ujërave ka mundësi që vendimi i kuvendit te komunës na ndihmon neve që me pas edhe atë hapësirë apo pronë me pas komuna ne menaxhim e që sot e ka dikush tjetër.

Kështu që materialin e ka te gatshëm drejtori Afrim Oruqi për secilin për ju edhe ka argumente te padiskutueshme ne kuptimin ligjor edhe pastërtia e historiatit te pronës është krejt ne rregull. Komiteti për Politike dhe Financa ka kërkuar që me gjete kohë që me shfrytëzuar maksimalisht kohen edhe po besoj që e kemi kapitalizue dhe unë kom pas dëshirë me qenë atë debat Burimi, Bejta që janë kon te ftuar por unë e di që është konsumuar edhe debati edhe ne fushën e argumenteve kemi nxjerrë atë që i takon një organi te caktuar siç është drejtorja për gjeodezi kadastër dhe pronë dhe gjithçka është pastër. Sa i takon presionit lirisht mundeni te ju thuani krushjanve se kryetari i Komunës ka marr vendim që me i mbrojte pronën e komunës se Rahovecit bashkë me kuvendin e Komunës. Por sigurisht që lirisht mund te ju them se nuk ka tension edhe pse ne fillim ka pasur pak mirëpo tani është pastruar tani. Mund te ju them se prona ne Rahovec është pak me ndryshe pasi ka kapak konteste, si kjo te stacioni atë vend e kemi rrafshuar mirëpo nuk guxojmë me veprua kurrëgj njëherë, dhe e kemi largu ne shfrytëzimi jo I drejtë jo I ligjshëm pasi dikush dikujt I ka marr qira dhe dihet ajo histori. Kështu që tash është pastër dhe s'ka asnjë lloj kontesti.

Sejfullah Sejfullahu – Nuk jam i shqetësuar pasi nuk kam ndonjë pretendim për atje dhe nuk kam ndonjë pronë timen atje. Mirëpo problemi qëndron se si autokritik që jam po e konsideroj që jam edhe unë pjesë, e shfrytëzuesve atje, ju duhet ta shikoni çështjen juridike pra te AKP-së pasi ka mbi 20 vjet që jemi marr me këtë çështje për me i nxjerr ata njerëz që kanë prona aty por nuk kanë mundur te bëjnë asgjë. Kështu që juridikisht prej tyre hiq mos ke dert pasi për te gjithë ata matrapazë që kanë bërë prona nuk mundet me bo asgjë pasi skan lan mjet pa përdor për shkak te dokumentacionit, por e kemi problemin vetëm me AKP-në dhe me askënd tjetër.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive, kolege asamblistë, media dhe gjithë ju te pranishëm. Edhe pse pak me vonesë erdha dhe nuk isha që nga fillimi i debatit te kësaj pike por jam i mishëruar goxha shume rreth asaj që ka ndodhur me herët. Ne, është fakt që kemi kërkuar me u mbajt një takim me qytetaret krushjan lidhur me këtë temë dhe jemi marr vesh që me u mbajt te hënën mirëpo emaili ka ardh edhe ky takim është mbajtur te shtunën. Kështu që me dëshirë do te kisha marr pjesë por ka ndërrua dita e mbajtjes se këtij takimi pasi jemi marr vesh që te mbahet te hënën mirëpo është mbajtur te shtunën, kështu që nuk është që nuk kemi marr pjesë pasi me gjithë dëshirë do te kishim marr pjesë pasi jemi marr vesh që me u mbajt ditën e Hënë dhe nuk ekziston asnjë rrezik për këtë pronë e qysh janë rrethanat e që po e dokumentoni me te gjitha atëherë pse nuk po mirëkuptohemi edhe njëherë që ne seancën e radhës ne mënyrë te rregullt pa i shtu pikat që te hyje edhe kjo si pike e rendit te ditës, pra le te vjen si pikë e rregullt e rendit te ditës ne seancë pasi ne Komitet për Politik dhe Financa është tërhequr që ta mbajmë këtë vijë dhe te rregullohet gjithçka.

Kryetari – Unë besoj që ky kalu neper filtrin e Komitetit për Politike dhe Financa dhe me siguri edhe aty është debatu dhe madje është debatu edhe ne kuvend jo mjaftueshëm dhe si konkluzë ka dal edhe një takim që dikush ka propozuar me pronaret shfrytëzuesit e dikush ka thënë që komiteti për Politike dhe financa me qenë aty dhe realisht kjo ka ndodh ndërsa për datën që u mbajt te shtunën për shkak se te hënën e kemi pasur serinë e konsultimeve publike pasi që janë 14 ditë përpara te njoftuar dhe nuk kemi dashur që me prish agjendën e kryetarit te komunës dhe kjo ka qenë çështja e gjitha. Unë po mendoj se kjo është e rregullt për shkak se ju ka nënshtruar këtyre filtrave edhe KPF-së edhe po ashtu është debatu ne kuvend dhe gjithashtu është debatu mjaftueshëm po besoj edhe ne Krushe te Madhe dhe sa i takon parandalimit, ne nuk mundemi me qenë te sigurt për asgjë sot për shkak se çudia me e madhe është për shkak se nuk i kemi mbrojt deri tash dhe nuk i kemi shpallur me interes te përgjithshëm deri tani jo vetëm ato prona por edhe shume te tjera sepse ne momentin kur merret vendimi i kuvendit te komunës atëherë ju jeni saktë dhe atëherë nuk ka mundësi me ndërhyje askush as gjykata dhe gjithçka merr fund dhe po besoj që ne jemi te vonuar madje edhe për shkak te agjendës që kemi edhe si kuvend i komunës e po ashtu edhe agjendës se kryetarit te komunës dhe te ekipit te tij pasi disa punë duhet te kryhen me shpejt. Nuk e kemi larguar gjithë rrezikun pasi dikush e përmendi se kurrkush s'ka rrezik prej kurrkujt pasi unë mendoj se ne kemi rrezik pasi dëshmi te mjaftueshme pasi edhe sot vazhdojnë gjuetaret e pronave dhe imagjinoni që kuvendi i komunës e ka materialin e gatshëm ne dorë te plotë dhe madje mund ta plotësojmë edhe me tutje që mund te shpërndajmë për secilin dhe dikush thotë që me shty me mirëkuptim. Mirëpo unë mendoj që nuk kemi arsye me shtyje si kuvend i komunës për diçka që është e gatshme dhe e pastër që me bo kaq shume debat kur faktet dhe argumentet janë ne favor te kuvendit te komunës se Rahovecit. Prandaj mos harroni që nëse futemi thelle e me thelle atëherë faktet që ne i disponojmë edhe për ato parcela, neve na obligojnë edhe për diçka tjetër që me hije ne veprime edhe me te veçanta me inspektor edhe me njësi te veçanta te policisë. Pasi që shfrytëzimi i paligjshëm dhe nxjerrja e gjuhës nga dikush për një shfrytëzim te paligjshëm atëherë e dini shume mirë se ka kundërveprim për këtë dhe nëse vazhdohet me disa situata te shantazheve atëherë shteti dhe kuvendi i komunës e ne këtë rast kuvendi i komunës është me i fort ndaj cilido që ka pretendime me vazhdua keq shfrytëzimin apo shfrytëzimin e paligjshëm te parcelave. Kështu që edhe për këta keq shfrytëzues shteti dhe ligji ka paraparë zgjidhje dhe unë po mendoj që sa nuk është zmadhua kjo gjë edhe me shume, ne një takim kur ka qenë KPF-ja atëherë ne fund te takimit kam thënë, pasi si kryetar i komunës e kam mandatin me vepruar me instrumente ligjore dhe ne zbatim dhe sundim te ligjit, pasi e kam pas shume vështir mirëpo kam vepru ne qytet te stacioni i autobusëve edhe përkundër faktit që ka pasur një histori me te përzierë. Në situatën ku është pronë e pastër komunale dhe ku ka shfrytëzim te paligjshëm te asaj prone ne emër te pretendimeve që dikush kërcënon atëherë ne jemi te obliguar me shpall me interes te përgjithshëm me vendim te kuvendit edhe menjëherë me shkua me veprime intensive sistematike te inspektoreve dhe policisë dhe nëse dikush pa te drejtë pretendon me i rezistua shtetit te vet, pasi e kam thënë edhe atë dit se fshati Krushe e Madhe ka dhënë shume me fshatra përreth e krejt komuna jonë. Por ne emër te kësaj askujt nuk i lejohet qe më pretendu që pa ligjshmëri me shfrytëzua parcelat te cilat janë te komunës se Rahovecit dhe ne momentin kur ne e marrim vendimin dhe nëse pretendohet që me vazhdu me shtyrje atëherë le ta dinë edhe mediat këtu nga kuvendi i komunës ka me vazhdu aksioni për largimin e shfrytëzuesve te paligjshëm pasi prona është komunale. Kështu që kushdo qoftë unë jam për zbatim te ligjit edhe e dua këtë vend siç e doni edhe ju. Me pretendu dikush me hije ne prone te komunës edhe me shfrytëzua paligjshëm edhe me ngrit zërin për diçka që vepron kundër ligjit pasi e dine shume mire që nuk kam asnjë hile ndaj askujt dhe e dine saktë se jam për me mbrojte pronën e komunës dhe po du me i dhanë kuvendit te komunës bashke me komunës që me zhvillua bizneset si agrokultura ferma e plot sene tjera që janë ne krushe siç janë edhe ne komunën e Rahovecit. Dhe një hapësirë që e ke ne dispozicion për disa parcela siç e kemi materialin e gatshëm dhe gjithashtu edhe te plotë për shkak se ka edhe historiat dhe gjithashtu e ke edhe verdiktin e gjykatës që s'ka asnjë lloj përzierje apo kontesti atëherë pse duhet me u vonua me u votu.

Sejfullah Sejfullahu – Tash po i bien që nëse na nuk e votojmë atëherë duhet me veprime tjera që me vepru. Mirëpo ne anën tjetër ata po besojnë në atë që ju ke thonë që nëse kalon kjo pikë, atëherë ata nuk do të ngucën rreth kësaj çështje. Kështu që për mos i dëmtua ata, ne duhet me votu pro kësaj, pra unë jam i interesuar që edhe pse janë shfrytëzues ilegal ashtu siç thoni ju, atëherë mendoj se duhet me votu për këtë. E kam thënë edhe me herët se ky është vetëm qëndrimi im dhe nuk duhet te lidhet askush me qëndrimin tim, e po ashtu janë edhe shefat e grupeve parlamentare dhe këto gjera duhet te kryhen me shefat e grupeve parlamentare.

Kryetari – mendoj se nuk e qes ne lajthitje kuvendin e komunës dhe nuk është dëshirë e vullnet e as përcaktim e as vizion. Pasi unë nuk bëj kompromis me ligjin pasi ligji neve na obligon që operatorët e paligjshëm me i largua nga veprimtaria po a me i detyrua e me i bo te ligjshëm me ndihmën e kuvendit te komunës. Kjo gjë nuk bëhet menjëherë pasi ka procedura,. Kështu që unë nuk bëj kompromise dhe nuk do te ishte mirë me bo asnjëherë por ne po themi që te tre parcelat propozohen me kalu ne rend dite dhe mu votu, pra me u mbrojte prona me vendim te kuvendit te komunës. Kështu që cilat veprime do te ndodhin ne te ardhmen mirëpo sikur dikush me teprua atëherë behet shume zhurmë rreth kësaj dhe ne jemi te detyruar me veprue edhe me mekanizma te inspektimit dhe me polici dhe me i largu si shfrytëzues te paligjshëm pasi që kemi dokumentacion që nuk dëshirojmë me keqpërdor sot.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, para se me kalua te votimi, e kemi edhe një propozim prej zyrës ligjore që është një vendim i marr ne seancën e kaluar ë e ka kthye ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës që është fjala për vendimin për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve rrugicave parqeve e shesheve dhe lagjeve ne komunën e Rahovecit i miratuar nga kuvendi komunal, kështu që për sqarim e ftojme zyrтарin ligjor para se me vendos ne votim.

Isak Hoti - Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Sot përmes postes elektronike dhe jo përmes emailit, i cili është shtyp me datë 27.05.2022 dhe sot ka mbërri te ne, kështu që na kanë kthye vendimin për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave parqeve shesheve lagjeve urbane ne komunën e Rahovecit. Arsyetimi për mua është banal i pa analizuar mirë sepse thotë se dispozitat e ligjit Nr.04 L 071 për sistemin e adresave dhe akteve nënligjore nuk përfshin formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve rrugicave parqeve shesheve dhe lagjeve urbane. Kështu që për neve kushtetute është ligji për vetëqeverisje lokale që neni 17 te kompetencat vetanake te shkronja O kush e ka ligjin përpara thotë emërtimi i rrugëve rrugicave dhe vendeve tjera publike. Pra te kompetencat vetanake thotë komunitat kanë kompetenca te plota dhe ekzekutive sa i përket interesit lokal duke respektuar standardet e përcaktuar ne legjislacionin e zbatueshëm ne fuqi sipas këtij ligji. Kështu që tash do te ishte mirë me shtie ne plotësim ndryshim dhe me ju tregu atyre që nuk është vetëm një ligj që rregullon një çështje por janë dispozita tjera që përfshihen ne ligje tjera.

Burim Krasniqi – MAPL-ja si monitoruese e jona ka thënë vendimi është ne rregull ne kuptimin procedural. Atëherë ministria e mjedisit është thirrur ne kompetenca, a do te ishte me e udhës me kthye një përgjigje me argumente si zyre ligjore e Komunës dhe me i dhanë hapësirë nëse ata nuk pajtohen me argumentin tone, atëherë neve na mbetet vetëm me shfuqizua vendimin tone. Pra mos me nguc vendimin që mos me shtie ne seancë dhe me kthye një përgjigje apo me ja dhanë një argument përgjigje ministrisë se ambientit dhe me shkua tutje.

Isak Hoti – Faktikisht këta e kanë kapur vetëm te ligji i adresave dhe ligji i adresave nuk e përcakton emërimin e rrugëve dhe ata nuk e kanë te qartë. Kështu që nëse e shohim ligjin pak me poshtë i kanë edhe kufijtë, kështu ne kemi te drejtë me i ndërrua edhe kufijtë nëse i përcjellim dispozitat e ligjit p.sh. dëshirojmë me bashku me një komunë tjetër dhe me bo bashke një komunë d.m.th. ligji na ka lejue dhe sa i takon kësaj pjese. Mirëpo ne vetëm e fusim si tekst plotësimi dhe ndryshimi i vendimit me kaq numër dhe me pastaj fillojmë. Pasi që nëse vonohemi pas afatit ligjor nuk dua me hije ne vargun e shume vendimeve që janë neper gjykata sepse është shume e panevojshme. Kështu që ne ashtu kështu kemi me komunikua me ata dhe nëse

është nevoja do të shkoj personalisht te departamenti ligjor në ministri të planifikimit hapësinor për me pae me tutje.

Kryesuesi –Faleminderit Isak, që sa e mora vesh unë kuvendi komunal duhet me marr një vendim këtij ndryshim plotësimi të këtij vendimi. Atëherë kemi tre pika shtesë krahas këtij rendi të ditës, ku ne pikën e parë të propozuar nga grupi i aleancës për projekt vendimin për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese, po ashtu edhe ne pikën e dytë e kemi të propozuar nga grupi i aleancës për projekt vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën Nr.02756-0 në zonën kadastrale në Krushë e Madhe dhe po ashtu e kemi edhe vendimin për formimin e komisionit për emërtimin dhe ri emërtimin e rrugëve rrugicave parqeve shesheve dhe lagjeve urbane. Atëherë po i vendosim menjëherë në votim 3 propozimet, 2 prej Arbër Zenunit në emër të Aleancës, projektvendimin për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese dhe projektvendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të parcelës në fjalë në zonën kadastrale Krushë e Madhe, poashtu edhe plotësim ndryshimin e vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit të miratuar në seancën e kaluar nga kuvendi komunal. Kush është për?...Atëherë me shumicë votash këto 3 pika shtesë të rendit të ditës i bashkohen rendit të ditës për seancën e sotme ku gjithsej janë 13 pika. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës si tërësi, kush është për?... Me votë unanime aprovohet edhe rendi i ditës për seancën e sotme. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës; shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për krytarin, ekzekutivin dhe të gjithë të pranishmit. Te procesverbali nuk kam ndonjë vërejtje të veçantë, por, besoj që duhet të përfshihet komplet rrjedhën e séances dhe pa keqkuptime te diskutimi i kryetarit e kanë moderuar goxha shumë fjalimin e kryetarit në procesverbal, ajo që thuhet nga secili duhet të jetë dhe të mbetet, kërkoj që edhe një here të degjohet inçitimi i seancës së kaluar dhe të plotësohet procesverbal si duhet.

Kryesuesi – Faleminderit Burim, atëherë propozimin e Burimit për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar po e vendosim në votim, kush është për që procesverbali të plotësohet dhe të bëhet gati për seancën tjetër?!...Atëherë me shumicë unanime procesverbali do të shqyrtohet dhe do të plotësohet edhe një herë, besoj që do të kemi mirëkuptimin e sekretarisë së kuvendit. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës; pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve, ndonjë çështje për të ngritur prej anëtarëve të kuvendit?

Burim Krasniqi – Faleminderit edhe një herë. Kam faktikisht 3 pyetje si Burim dhe si grup i asamblistëve të LDK-së. E para, te rruga Xërxë - Rahovec katër shiritore, e shikova ligjin për buxhet dhe pashe që ka buxhet prej 1 milion euro për këtë vit, por nuk po shoh ndonjë aktivitet, pse nuk po ndodh aktiviteti? Pastaj për drejtorin e financave, kontrata thotë që është 2019-2024, 5 vite parashihet me buxhet, a jemi në rregull me ligjin e prokurimit? A mundet me qenë 5 vite zbatimi i një kontrate për një projekt të caktuar? Për drejtorin e kulturës rinisë dhe sportit, te çështje investimit te epopeja e UÇK-së, a është zonë rekreacioni, fushë futbollit, stadion? Për drejtorin e Urbanizmit e kam një pyetje dhe shpresoj që seancën e radhës ta kem një përgjigje, objektet kolektive a duhet të kenë pranim teknik? Në këtë rast për shkollat; kemi në funksion shkollën e Hoçës Vogël, Fortesës, së shpejti shkolla e Krushës së Madhe dhe objektet tjera, a duhet të kenë pranim teknik dhe a duhet të kenë leje për shfrytëzim? Sepse sa i përket lejes për shfrytëzim përpos kushteve teknike që iu kanë përmbajtur projektit, janë edhe disa kriterë tjera, në rast zjarri, në rast fatkeqësie të shkallës emergjente. Pra, a duhet të kenë pranim teknik dhe e dyta a duhet të kenë leje për shfrytëzim prej komisioneve profesionale.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, desha të ndërlidhem te përgjigjet nga drejtori i bujqësisë gjegjësisht drejtoresha e shëndetësisë. Rreth pjesës së tregun që e kanë parashtruar pyetjen se pse në kohë pandemie është ndërmarr, është një përgjigje goxha e detajuar, por si nën përgjigje dhe në atë që kërkoja është dashur të ceket që ka qenë një farë infuzioni për përdorimin e atyre pjesëve për treg, sot thahen dhe janë të demoluara dhe askush nuk jep përgjigjësi për atë pjesë, pasi është investuar është “gjynah” mos të shfrytëzohen. E dyta, unë nuk e kam cekuar asnjë emër te pyetja për drejtoreshën e shëndetësisë, por këtu ajo e paska cekur që; z.Halil Çanta i cili ishte i punësuar në QKMF, i është ndërprerë kontrata neni 67, paragrafi 1 pika 1.3 dhe asgjë më

tepër. Unë konkretisht kërkoja se a është në rregull që t'i ndërprehet aq më shumë një doktori që ka qenë shërbyes i qytetarëve aty dhe t'i ndërprehet kontrata pa paralajmërim së paku një muaj më herët do të ishte më njerëzore. Mora përgjigje që është ndërpre kontrata, por kërkoja se a është dashur së paku një muaj më herët të informohet, pa marr parasysh se kujt i ndërprehet kontrata, t'i ndërprehet së paku me një paralajmërim e jo në mënyrë ad hoc prej sot ose prej nesër më nuk je në punë!... Është jo etike dhe jo e moralshme një gjë e tillë sidomos për doktorët që kanë dhënë shumë në kohë pandemie.

Leonard Morina – Përshëndetje kryesues, përshëndetje kryetar, drejtorë, kolegë asamblistë, media. Unë do të ndërlidhem me pyetjen që ia kam bërë drejtorit të arsimit, pyetja ka qenë; Si po i kaloni mësimdhënësit me kontrata të përkohshme në kontrata të rregllta, pa konkurse? D.m.th kjo pyetje nuk ka marrë përgjigje. Përgjigjet e juaja nuk po them 90%, por 100% janë të pasakta në email. Shkollat e përmendura ia kanë pa hajrin, mbas një jave keni dërguar mësimdhënës, në shkollën e Drenocit që është paralelja e ndarë në Senoc, në Malësi, në Polluzhë e gjithkrah, të ka bërë mirë ty dhe nxënësve dhe i bie që e keni përmirësuar sjelljen në arsim. Këto pika të cekura në email janë përgjigje qyqare sepse nuk kanë asnjë argument janë fraza të thata. Unë për dallim nga ti, do t'i argumentoj të gjitha gjërat e cekura. Në pikën e tretë keni thënë që në shkollën "12 maji" në Ratkoc, mësimdhënësit janë profesional, unë këtu e kam një fletë të ditarit ku shihet që mësimdhënësi që mbanë fizikë (i ka orët e shënuara) e është me teknologji, ky është dokument zyrtarë mundet edhe inspektorati të vazhdoj të vërtetoj të saktën. Pika 4, keni thënë se janë të pavërteta prapë, nuk është profil përkatës mësimdhënësi Leonard Morina e kemi marrë si zëvendësim me kontratë të përkohshme, sipas udhëzimit administrativ unë jam bachelor i programit matematikë-informatikë me 240 kredi dhe jam i profilizuar për mësimdhënës i matematikës në fillore, nëse ju keni ndonjë udhëzim administrativ tjetër, mundeni të më demantoni. Sa i përket kontratës time që është e përkohshme që i keni vendosur disa numra aty, për mua nuk janë fare të rëndësishme, nuk e keni gjetur njeriun që e frikëson me data, datat dhe kontratën m'a përcakton ligji, jo Avni Morina. Pika 5, artikulet e Leonardit janë të pasakta, ja faktet, listat e kandidatëve që janë punësuar që i kemi marrë prej faqes së komunës, kandidatët që nuk janë në listë të testit me shkrim, ku janë në listë që janë në test me gojë? Inspektorati edhe këtu ka punë, mundet me u marr me këto fakte. Njëjtë, mësimdhënësi i teknologjisë (këtu janë fletët e ditarit) të datës 14.10.2021 që mbanë matematikë në Malësi të vogël dhe më 26.05.2022 që ende mbanë matematikë në Malësi të vogël, nëse këto janë të pavërteta atëherë shikoni ditarët se kush po i mbanë orët. Në pikën 6 Avni Morina bënë një gënjeshtër tjetër, aludon se isha nxënës i tij, asnjëherë Avni Morina nuk më ka dhënë mësim mua, përndryshe ndoshta nuk do të isha këtu ku jam. Në fund thotë që njerëzit si unë meritojnë respekt, si mund të kem respekt për një drejtor i cili prej 2 faqe të emailit asnjëherë nuk e shkruan saktë. Për njerëz që gënjejnë nuk mund të kem respekt drejtor. Faleminderit.

Kryetari – Përshëndetje, ndoshta do të ishte më mirë ti presim me shkrim përgjigjet nga pyetjet nga mbledhja e kaluar, sidoqoftë e ndjeva si obligim moral dhe për respekt t'i përgjigjem Burimit në 2-3 çështjet që i ngriti; E para rruga 4 krosi, financohet nga ministria planifikimit hapësinor infrastrukturës (po ia ndërrojnë emrat vazhdimisht) edhe sivjet ka buxhet, por besoj që ndoshta është e rastit dhe besoj që jeni në dijeni të gjithë që kemi një rritje enorme të çmimeve dhe njëkohësisht kemi një shpërputhje të madhe me kontratat që janë lidhur më herët. Edhe në çoftë se qeveria e republikës së Shqipërisë i ka dhënë zgjidhje kësaj situate pas rritjes së çmimeve me kontratat të cilat janë nënshkruar para rritjes së çmimeve edhe qeveria e Maqedonisë së Veriut, operatorët ekonomik edhe të komunës tonë edhe të republikës së Kosovës janë në pritje të një sinjali që e ka dhënë qeveria e Kosovës për subvencionimin ose mbulimin e humbjeve në masë diku 25- 30% se si është kërkuar, duke marrë shembull në 2-3 shtete të rajonit, kështu kanë vepruar, prandaj aktivitetet në terren janë ndërprerë nga shumë operatorë. Poashtu edhe ne jemi në pritje duke provuar t'i rikthejmë në punishte, se në fund të fundit ne e kemi për obligim zbatimin e kontratave sipas ligjit, por kemi vështirësi serioze në nivel lokal dhe në nivel qendror për t'i kthyer në punishte operatorët që kanë nënshkruar kontrata më herët. Shpresojmë për një epilog pozitiv nga një vendim potencial prej qeverisë ose ia propozon kuvendit të

republikës së Kosovës që përmes bankës qendrore (Burim, po e kupton çka po flas). Te epopeja e UÇK-së mbi qytet, e di që i kam hy pak në hak Biondinës dhe Afrim Dinës po ndoshta edhe Hasanit. Bëhet fjalë për një terren sportiv, kompleks sportiv, jo për stadiumin, projekti kryesor për stadium unë e kam nënshkruar një memorandum me ish ministrin Kujtim Gashi (nënkryetar i komunës së Prizrenit) por nuk kemi lëvizje përpara, as për stadiumin e kategorisë së dytë në Rahovec që është te epopeja e UÇK-së as për palestrën sportive në Krushë të Madhe e as për stadiumin në Ratkoc. Pra, ka pas një procedurë të prokurimit, është ndërprerë, kodi ekziston- mjete për moment nuk ka për asnjërin prej këtyre 3 projekteve që financohen nga ministria e kulturës rinis dhe sporteve. Sa i përket objekteve publike, p.sh; ne para disa ditësh e kemi përfunduar shkollën fillore “Sadedin Hajda” financim drejtpërdrejtë nga ministria e administratës publike që është nisur nga koha e kryetarit Idriz Vehapi, është vonuar realizimi dhe pranimin teknik dhe realisht rolin vendimtar e ka departamenti i projekteve bashkë me ministrinë e arsimit dhe besoj që standardet që ata i kanë paraparë i kanë plotësuar. Ne i kemi vërejtjet tona, në cilësinë e vëzhguesit edhe te operatori edhe te departamenti i projekteve në kuadër të ministrisë. Pra, pranimin teknik ata e kanë marrë përsipër. Në komunë të Rahovecit ka rreth 5 vite që nuk bëhen pranimet teknike si nëpër disa komuna tjera të republikës së Kosovës, por merret në konsideratë stacioni i fundit dhe garancia (ne i kemi dy vite, dikush më pak e dikush më shumë). Pra, zakonisht kur ministria financon, bënë pranime teknike. Bejtullah Deliu Po, unë po besoj që këtë javë shpallet faza e tretë dhe përfundimtare të kompletimit të tregut të rrushit në Rahovec. Ato objekte apo “tezga” vendet ku vendosen pemët dhe perimet do të riparohen sepse është nën garancinë të atij që e ka pas fazën e dytë. Faza e tretë nënkupton rrethojë dhe disa standarde që duhet t’i plotësoj një treg funksional i rrushit dhe besoj që me 2 shtator (kur mendohet të filloj Hardh Festi) po supozojmë ta përmbylлим edhe fazën e tretë dhe të aktivizimi bashkë me Hardh festin edhe tregu i madh i rrushit. Aty ani me një “pëlqim” operojnë edhe auto shkolat, kur ishte pandemia ne kemi pasur edhe kufizime gati edhe bllokada, meqenëse nuk lejohej tregu këtu brenda, ideja ka qenë shkaku i hapësirës së madhe t’a dërgojmë një grup të caktuar të fermerëve dhe e dini që ndodhi ajo që ndodhi, nuk na lejuan as atje. Shkojmë te ndërprerja e kontratës të fizioterapeutit, situata është kjo; ligji neve na obligon të forcojmë mekanizmin që është kryekëput mjekësi familjare dhe ka ndodh një ankesë, fatkeqësisht më vije keq, këtij është dashur që çdo 6 muaj t’i vazhdohet kontrata, punë të madhe ka bërë fizioterapeuti Halil Çanta, sepse çdo kush ka nevojë për fizio terapi, vet bashkëshortja ime ka qenë, po ja që ligji na ka pamundësuar sepse kur është ngritur aktakuzë për këtë çështje ai është dashur të jep vet dorëheqje sepse ndoshta e kish ndihmuar procesin, jo që ka qenë dëshirë e jona, por prokuroria ka reaguar edhe është dashur të jep dorëheqje. Kur ka ardhë momenti kur atij u është dashur t’i vazhdohet kontrata, ai ka qenë në dijeni që nuk i vazhdohet edhe për 6 muaj tjera. Kjo nuk ka qenë dëshira jonë sepse ka nevojë QKMF-ja jonë për angazhime të këtij profesioni për arsye se ankesat e njerëzve në nevojë janë të mëdha. Përkundrazi unë e kam edhe mik Halilin por, e kemi kryer detyrën tonë sepse prokuroria ka thënë që dikujt iu ka ngritur aktakuzë për një gjë “pa lidhje hiç” por ata kanë vepruar në bazë të ligjit dhe ne është dashur t’ia ndërprejmë kontratën, në këtë rast mos t’ia vazhdojmë, e kemi pritë deri në ditën e fundit dhe ai ka qenë në dijeni që nuk i vazhdohet sepse 6 mujori i fundit po afrohet dhe ka qenë me i sikletshëm për neve sepse tani ne nuk e kemi fizioterapeutin aty. Leonardit doja t’i them kështu, ky Gjergj Gojani kish dal në pension edhe kur të hapet ai vend është mirë të aplikoni, e dyta; zakonisht kur merr të dhëna zyrtare, duhet të kesh kërkesën për qasje në dokumente publike, a po kuton, është një shkelje... nuk dëshirojmë të qesim para gjyqit, por secili asamblistë dhe secili qytetarë e ka të drejtën të kërkoj qasje në dokumente publike, që të shkoje e t’a fotografoje një ditar atje, të skanosh diçka etj...Mos harro se je shef i grupit goxha të rëndësishëm politik dhe sundimi i ligjit është prioritet i qeverisë së republikës së Kosovës.

Leonard Morina – Faleminderit, te Gjergj Gojani po e lë Shqipe Kryeziun për aplikim. Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, këto i kam marrë prej web-faqes së komunës, që janë konkursat me emra të mësimitdhënësve që kanë aplikuar. Këto fleta m’i kanë dhënë njerëzit që i kanë parë shkeljet dhe kanë dashur

t'a përmirësojnë shkeljen, më vështirë është të bëjmë shkelje se sa të tregojmë shkelje, kështu që unë kërkoja përgjigje për këto veprime, jo për letra.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, i nderuar ekzekutiv, anëtarë të kuvendit komunal. Unë e kam pranuar një përgjigje nga ana e drejtorit, për pyetjet e parashtruara, për projektin; rregullimi i shtretërve të lumenjëve të fshatrave Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe. Drejtor, këtë projekt e zhvillon komuna e Rahovecit, neve na ke dërguar disa pasqyra, disa tabela, deri tani për këtë projekt janë investuar 270.000eu, e dimë edhe që është ndalur puna, por se di a i keni njoftuar operatorët ekonomik që gjatë punimeve shumë prona të fshatit Brestoc kanë mbetur të papunuara për shkak të mbeturinave që ata i kanë bërë gjatë punës së rregullimit të shtretërve të lumenjve. Pritet nënshkrimi i një aneks memorandum, kur do të nënshkruhet ky memorandum, çfarë hapi keni bërë ju, të na jepni përgjigje në këtë drejtim. Për investimet që janë bërë 270.000eu, prej informatave që kam ajo pjesë ka nisur prapë të dëmtohet, në Brestoc është bërë ky investim, pak në Hoçë, nuk e di ku tjetër janë investuar këto mjete, presim përgjigje. Faleminderit shumë.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryesues, nënkryetar, kolegë asamblistë, drejtorë të drejtorive dhe ju media të pranishme. Unë e kam një kërkesë që i drejtohet drejtorisë së inspektoratit, saktësisht drejtoreshës Nora Boshnjaku. Në lagjen e epërme, saktësisht në rrugën “Avdullah Bugari” në përfundim të kësaj rruge dhe ku fillon rruga “Mizair Isma” nëse e keni parasysh semaforat e rinjë ku janë (përpjetëza), te kthesa ku bashkohen këto dy rrugë, para 2 muajve është bërë një prerje e asfaltit prej KRU-Gjakovës, banorët e lagjes dhe unë iu kemi drejtuar KRU-Gjakovës me kërkesë, kemi biseduar në telefon duke i kërkuar të rregullohet sa më shpejtë ai problem që është aty sepse është një prerje shumë e thellë dhe është kthesë, në këtë rast shoferët nuk mund t'a vërejnë duke dëmtuar edhe veturat. Pasi KRU-Gjakova nuk dëshiron të marrë vesh gojarisht nga kjo kërkesë legjitime prej qytetarëve, atëherë të aktivizohet inspektorati për arsye që ky defekt ka mbi dy muaj dhe nuk besoj që është e tolerueshme. Një replikë për shefin e grupit të VV-së, por pasi që nuk qëndron në sallë, po e lë për mbledhjen tjetër.

Besë Bytyqi – Shumë faleminderit, pyetjet e shefave të grupeve si dhe të Hasanit e Lirigzonit dëshiroj t'i përmbylli me një urim për kryetarin e komunës, stafin politik si dhe stafin e nëpunësve civil për vendin e parë në grandin e performancës, kam menduar që edhe të tjerët do të urojnë dhe shfrytëzojnë rastin në emër të grupit të Aleancës t'iu uroj një shumë prej 1 milion e 100 e disa mijëra euro (nuk po e mbajë në mend mirë), e di që këto mjete do të shkojnë në të mirë të qytetarëve, i përgëzoj jashtëzakonisht për punën dhe uroj me qenë në toplistë shumë gjatë.

Burim Krasniqi – Besë, shefe e grupit të aleancës, mirë që e lavdërove kryetarin, por është dashur të falënderohet kolegët asamblistë të mandatit të kaluar sepse poenët më të mëdha të mundshme e ka marrë puna e asamblesë komunale, pozicionet tjerat kanë nga pak çalime, por duhet të falënderojmë Afrimin, kryesues që ka qenë edhe kolegët asamblistë për grantin dhe jo vetëm kryetarin e komunës.

Kryetari – Ka edhe tregues që kanë të bëjnë me performancën e kuvendit të komunës, janë evidencat, angazhimet dhe mbledhjet e kuvendit të komunës, veprimet që kthehen prej MAPL-së të gjitha këto, prandaj nëse ju kujtohet Burim se kur thoja “o njerëz mos t'i vonojmë gjërat se ministria mund të na ndëshkoj” prandaj meritat janë të qytetarëve të komunës së Rahovecit, të organeve të zgjedhura të komunës së Rahovecit, poashtu të ekipit tim dhe kemi synuar edhe më shumë, kemi pak problem sepse ende nuk e kemi PZHK-në, hartën zonale që po t'i kishim edhe këto ne me kilometra do të ishim më larg se tjerët, shpresojmë që sivjet do t'i arrijmë edhe këto dhe e shohim që në vitin 2022 do të dalim edhe më mirë. Më e rëndësishmja është që 1.148.890.77eu kjo si thonë gjakovarët këto janë “qyl” kemi mundur edhe hiç mos t'i marrim.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit, kryetar a bën të qëndroni edhe një minutë, është shumë me rëndësi; prej meje i keni dy lajme, së pari e donë urimin apo kritikën?...Urime që je shpallur “qytetar nderi i Përmetit” edhe pse jemi opozitë ne gëzohemi dhe na vije mirë. Kritika është se të duhet bashkëpunimi, siç i thekë edhe Burimit

edhe mua, nuk është keq apo marre që edhe ndonjë prej opozitës t'a marrësh me veti edhe atje te zona e turizmit që keni qenë edhe në Përmet.

Kryetari – Vetëm me familjen time kam qenë, kemi pas qejfi t'i marrin shefat e grupeve, por bashkia e Përmetit financiarisht është më e dobët se sa komuna jonë, nuk kemi dashur ta ngarkojmë.

Kryesuesi – Në emër të kuvendit komunal, unë e uroj kryetarin, më saktësisht komunën e Rahovecit me grupin punues për grantin e performancës. Meritat i takojnë shërbyesve civil por edhe kryetarit për vendin e parë për performancë, gjithmonë i përshëndesim gjërat e mira si kjo. Më lejoni që si kryesues t'ia uroj ditëlindjen anëtarit të kuvendit Alban Bajraktarit, vazhdojmë një pauzë një orësh, deri 13:15 ju lus të ktheheni në kohë.

Kryesuesi – Përshëndetje edhe një herë për të gjithë, i nderuari kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive, po e vazhdojmë seancën pas pauzës, kemi mbetur te pika e dytë që është e papërfunduar, nëse ka ndonjëri ndonjë pyetje për ekzekutivin?

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues, të nderuar të gjithë të pranishëm, po flas edhe unë diçka kësaj radhe pak për përmbajtje, më shumë për formë. Desha të bëjë një kërkesë për parkingun te palestra, e di që është në kuadër të projektit të sheshit, nëse nuk jam gabim, po meqenëse sheshi po na del një serial i gjatë, a ekziston ndonjë mundësi të rregullohet të paktën pjesa e epërme e parkingut, momentalisht aty veturat parkohen veç prej “zorit”, e nëse vazhdon të mbetet kështu, atëherë tërësisht parkingu do të bëhet i papërdorshëm. Pastaj për nga forma është e llojit të vet. Në mes të qytetit çoftë edhe një muaj të mbetet në atë gjendje ai parking është tmerr, fatkeqësisht ka vite që është ashtu kryetar! Ai është një prej vendeve që frekuentohet më së shumti në komunën tonë, prej banorëve jashtë komunës sonë, fal palestrës. Çfarë përshtypje i japim ne vizitorëve në mes të qytetit? Për fund po e bëjë një propozim, Rumir, drejtor dhe kryetar, nëse nuk janë mundësitë të rregullohet vetëm ajo pjesë, a ekziston mundësia që ndërtimi i sheshit të filloj pikërisht prej asaj pjese? e kur të sigurohen fondet të vazhdoj pjesa tjetër, që mos të mbetet në atë gjendje.

Kryetari – Po Ilir, e kuptova. Realisht aty nuk është parking, po thjesht improvizim, aty ka qenë tepër më keq për shkak të ekoregjionit me pajisjet e veta. Në çoftëse do të kemi mundësi të lidhim kontratë për shesh, atëherë po mund të nisim prej aty dhe të rregullohet infrastruktura sipas projektit. Parkingjet ende i kemi jo të menaxhueshme, sepse ndoshta duhet kuvendi i komunës të shqyrtojë mundësinë që në një nga pikat e rendit të ditës të bëjë dhënien në shfrytëzim të parkingjeve të cilat tani janë falas, por me një menaxhim më të përgjegjshëm të shpallim ankandin në hazë të investimeve se kush e ka ofertën më të mirë t'i bëjmë parkingjet me standarde tjera. Në rrugën “Ibrahim Rugova” do të shtohet një parking i ri tash me rrugën një kahëshe, vetëm jemi duke pritur lidhjen e kontratës. Jam dakord me atë që është shqetësim sepse parkingu aty është pa standard, kush e zë vendim më herët e as nuk është e rregulluar mënyra e parkingut kështu që në zbatim të kontratës potenciale për shesh, fillojmë aty. Tani e gjashtë muaj jemi në pritje të rishpalljes së procedurave të prokurimit për shesh qendror.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, nëse nuk ka askush ndonjë diskutim, atëherë po vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen rezervë në investime kapitale, ndonjë çështje prej anëtarëve të kuvendit sa i përket kësaj pike? Drejtori Afrim Limani e ka fjalën për prezantimin e kësaj pike.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, asamblistë dhe gjithë të pranishmit. Bartja e rezervave d.m.th nga viti 2022. Për shumicën nga ju që jeni legjislaturë e re, besoj që nuk e dini çka është “rezerva”. Atëherë rezervat janë pjesë e investimeve kapitale të cilat nuk e kanë kaluar udhëzimin administrativ 04/2019 dhe me aprovimin e departamentit të buxhetit në ministrinë e financave këto janë projekte rezervë në kuadër të komunës së Rahovecit. I kemi gjithsej 10 projekte dhe shuma për këto projekte në total është 690.000eu nga granti janë 550.000eu ndërsa nga të hyrat vetanake 185.000eu. Edhe një informatë, ky është viti i dytë që ka filluar aplikimi i këtij udhëzimi administrativ dhe të gjitha këto projekte kapitale d.m.th në vitin 2020 kanë kaluar nëpër këto filtra dhe kanë kaluar, ndërsa për çudi tani në vitin 2022 iu kanë nënshtruar këtyre filtrave por nuk kanë kaluar. Pa marr parasysh se si është krijuar situata, drejtorja për

financa dhe buxhet pas një analize të thellë të këtyre projekteve kemi bërë edhe bartjen e këtyre projekteve duke analizuar gjendjen e investimeve kapitale, informatë tjetër është se me të gjitha projektet ne kemi kontrata të lidhura duke përfshirë këtu obligimet financiare, atëherë qëllimi edhe ideja është që bartja e këtyre të bëhet përafërsisht në mënyrë analoge në kuadër të projekteve që e keni materialin para jush, për fund, shuma për 550.000eu që është pjesë e grantit, nëse nuk votohet atëherë kjo shumë rrezikohet të kalojë në suficit.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Drejtor, në bashkëbisedimin që e kemi pasur është thënë që arsyeja kryesore e bartjes së mjeteve rezervë është për shkak të keq kualifikimit që ka ndodhur gjatë draftimit të buxhetit. Te departamenti i bujqësisë te kodi 40827 që është participim në projekte në bashkëfinancim në bujqësi, në ligjin për buxhet janë 50.000 prej grantit qeveritarë dhe 30.000 janë prej të hyrave vetanake që aktualisht janë 80.000 komplet të parapara. Po kërkohet të barten edhe 300.000 të tjera në të njëjtin projekt, e të cilat defakto janë të njëjtat projekte që janë te bartja e mjeteve rezervë, pra do të ketë përkrahje të fermerëve të mekanizmave bujqësor, ndërtim të serave, stallave etj.. d.m.th të njëjtat veprime do të ndodhin, por përmes kodit buxhetor në participim me projekte në bashkëfinancim në bujqësi. Unë në E-Prokurim e pashë që komuna e Rahovecit ka nënshkruar një kontratë prej 850.850eu për mekanizma bujqësorë për fermer, pyetja është: A mund të ndodh që prapë të jetë bashkëfinancim në mekanizma bujqësorë siç është kodi 466674, 47832, 47865 që janë prapë: mekanizma bujqësorë, stalla, miniferma, por vetëm që po bëhen prej një kodi tjetër dhe veprimi që ndodh gjatë pagesave po del të jetë që nuk është investim kapital por është mallra dhe shërbime. D.m.th titulli është investim kapital i pranuar prej ministrisë së financave i kodit për participim në mjete në bashkëfinancim në bujqësi por veprimi që ndodh kur paguhen mjetet e mekanizmit bujqësor është subvencion, nuk është investim kapital, kjo i bie që është titulluar ndryshe që parimisht është e njëjta gjë. Meqë jemi te bartja e mjeteve, si shqetësim e kam: kjo shifër 850.850 a do të na bie prapë në këtë situatë të ngjashme, sepse diku mbesin edhe 520.000 tjera për vitin 2023-24 e tutje, sepse në ligjin për buxhetin nuk e kam parë që janë 850.000eu të alokuara për mekanizma bujqësorë.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues, ne si grup i lëvizjes vetëvendosje propozojmë që nga bartja e mjeteve rezervë të ndahen 30.000eu për subvencionimin e sporteve, përkatësisht grup moshave të reja dhe 30.000eu të ndahen në kodin 48208 për furnizimin e shkollave me teknologji informative, mos të harrojmë që në komunën tonë nuk ka vetëm bujq, por ka edhe nxënës që kanë nevojë për mjete për konkretizim dhe sportist të ri që kanë nevojë për subvencionim.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, në emër të grupit të asamblistëve të LDK-së, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës për bartjen e mjeteve vetanake, propozojmë që këto mjete të ndahen në dy kategori: në shërbime publike (ndërtimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit) propozimi për ndarje është 100.000eu dhe në zhvillimin ekonomik, kodi i projektit 45690 investim në zonën ekonomike në Optrushë, propozimi për bartje këtu është 140.000eu. Kërkojmë nga kryesuesi që këtë propozim t'a vendosë në votim.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje kryesues, konsiderojmë që bartja e mjeteve të shfrytëzohet në sektorin e bujqësisë me kod ekzistues 421 që është funksional, me bartjen e mjeteve që e bëmë të shkojnë për një ndërtim të një depoje bujqësore me Komore ftohëse me rreth 150.000-200.000eu për këtë objekt.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, grupi i AAK-së e përkrah propozimin e kryetarit me të gjitha këto kode buxhetore si dhe me nën programet, kodet, përshkrimin e tyre, kështu që ne jemi PRO këtij propozimi të kryetarit.

Afrim Limani – Burim, faleminderit për pyetjen.! Këto projekte iu kanë nënshtruar udhëzimin administrativ 04-2019 dhe kanë kaluar në rezerva. Këtu është edhe keq klasifikimi d.m.th një numër i madh i projekteve janë si rezultat i keq klasifikimit dhe si rezultat i emërimit të gabuar. Për të marr karakterin e një projekti kapital të paktën në përshkrim duhet të figuroj si ndërtim dhe ky kishte me qenë gabimi dhe për këtë arsye ka ndodh kjo. Nuk po hyjë më në detale, sepse e keni nëpër emaila, kush ka qenë i interesuar e ka lexuar. Pyetja

tjetër ishte nëse do të përsëritet situata e njëjtë në projektin participimi në bashkëfinancim në bujqësi kodit 40-827, fatbardhësisht ky projekt nuk është në pjesën rezervë, ligji na lejon që këto mjete t'i bartim në kuadër të këtij projekti me kusht që t'i paguajmë faturat dhe obligimet financiare që i kemi deri më tani. Në kuadër të këtyre projekteve kemi edhe kontrata edhe obligime financiare dhe ne detyrimisht në mënyrë analoge në kuadër të projekteve t'i bartim mjetet në mënyrë t'i kryejmë obligimet ndaj operatorëve që i kemi. Ju siguroj dhe ju garantoj që këto procese do të kryhen, pa ndonjë problem. Sipas ligjit këto rezerva kryesisht janë projekte kapitale dhe gjithashtu bartja duhet të jetë në projekte kapitale në këtë rast në subvencione nuk mundemi. Propozimin që e dha Leonardi dhe Lirigzoni, kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj sepse kemi kontrata në kuadër të këtyre projekteve si dhe obligime financiare dhe mund të na priset situata totalisht. Në këtë pikë kërkoj mirëkuptimin e juaj.

Kryetari – Unë e mirëkuptova Burimin, nuk është çudi që vitin e ardhshëm të kemi përsëri situata të reja ligjore dhe ta akceptojmë si keq klasifikim, pra asnjëherë nuk mund të jemi të sigurt, por tani jemi në përshtatje të situatës sepse kemi bërë konsultime edhe me departamentin e buxhetit, Burim dhe nuk është çudi që auditorët ose qeveria nesër të fusin në zbatim një udhëzim të ri me plotësim-ndryshime dhe kjo që po bëjmë sot në të ardhmen të konsiderohet keq klasifikim. E mirëkuptova edhe Lirigzonin, dëgjo Lirigzon, ne 80.000eu i kemi prej grantit që e kemi fituar për ndriçim publik dhe jemi në përmbyllje të kontratës, ndërsa për depon bujqësore kemi ndarë një grant mbi 80.000eu vetëm për komora dhe depo, plus këto që i kemi bërë me bartje dhe mendoj që kalkulimi i drejtorit të financave është bukur i analizuar me kujdes, edhe subvencionet mund të rriten por jo në këtë fazë. Në seancën e kaluar drejtori i financave ka thënë që për vitin 2023 kemi mundësi që subvencionet t'i rrisim deri në 800.000eu kjo e gjitha për shkak të ikjes së keq klasifikimeve, ndërsa sivjet i kemi 361.000eu për të gjitha kategoritë e subvencioneve dhe transferove. Ne kemi obligime financiare, ky fond i rezervës duhet të destinohet për investime kapitale. E shihni një shumë të madhe aty në bujqësi d.m.th kemi kontratë 850.000eu dhe për shkak të mosfunksionimit të OSHP-së vonesat kanë qenë enorme dhe ne me 26-27 mars të këtij viti e kemi nënshkruar kontratën sepse kanë përfunduar të gjitha procedurat, janë 6 lote, 2 lote i ka një kompani e Rahovecit dhe kemi obligim ndaj përfituesve dhe jemi në një situatë ku kontrata është nënshkruar dhe mekanizmat po vijnë dhe besoj që kjo shumë që është në kodin për bashkëfinancim duhet të përkrahet nga kuvendi në mënyrë që të shkojmë në një trend normal të zbatimit të pagesës financiare të kontratave. Financa rezervë tash është investim kapital, nuk është mallra dhe shërbime, ky fond nëpër kode dhe projekte kapitale, çdo interpretim tjetër është gabim sepse siç tha edhe Burimi rezerva është krijuar sepse ka ndodh keq kualifikimi, atëherë ne i kemi gjetur kodet si investime kapitale dhe ky është thelbi i shpjegimit dhe besoj që jam tepër i qartë.

Afrim Limani – Ilir, po të adresohem ty, a është neni 15 ligjit mbi financat publike dhe përgjegjësi? E kam lexuar ligjin-nenin dhe e di shumë mirë si dhe kam qenë edhe në konsultime me departamentin e buxhetit. Shumë e qartë është aty shkruan: përpos në pozicionin e pagave në kategori tjera mund të vendosim mjete, mirëpo në këtë rast komuna e Rahovecit të gjitha rezervat burimin e kanë nga investimet kapitale. Buxhetin në subvencione ne e kemi të planifikuar më 16 shtator të vitit të kaluar me tavane të njëjta dhe i ka limitet, ato mjete kanë ngelur aty, rezervat kanë rrjedhur prej investimeve kapitale dhe detyrohemi t'i vendosim në kuadër të investimeve kapitale. Ilir, sikur pjesa e subvencioneve të kishte kaluar në rezerva atëherë ne kishim mundur t'i bartim, por komuna jonë nuk e kemi atë situatë dhe burimi i krejt këtyre është që rezerva ka rrjedh nga investimet kapitale dhe detyrohemi me vendos në kuadër të investimeve kapitale.

Kryesuesi – Fillimisht i kemi tre propozime: në emër të grupit të LDK-së e kemi propozimin e Lirigzonit, propozimin e Leonardit dhe të Bejtullah Delikut. Po i vendosim fillimisht propozimet në votim në çoftëse marrin mbështetje prej anëtarëve të kuvendit... Atëherë kërkoj prej anëtarëve të kuvendit që kanë propozuar të jenë më korrekt me propozime.

Leonard Morina – Propozoj që këto mjete të merren prej kodit 47011 bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.

Kryetari – Me mirëkuptim e kisha ftuar Leonardin dhe të gjithë propozuesit, që u sqarova pak a shumë me Lirigzonin. Dëgjoni, ne mund të kemi propozime por ky kodë për bujqësi është shumë e madhe dhe mendoj që ka impakt te bujqit por edhe te operatori që fatbardhësisht është i komunës tonë. Propozimet e juaja, depon bujqësore dhe ndriçimin publik ne i kemi trajtuar në forma të tjera sepse kemi ndarë edhe grant. 850.000eu është kontrata e cila është nënshkruar sivjet dhe është nisur vitin e kaluar për shkak të mosfunksionimit të OSHP-së. Çdo propozim është legjitim, por iu kisha lutur që kësaj radhe të pajtohemi me orientimin që e kemi nga drejtoria e financave dhe shpjegimin nga drejtori i financave. Këto propozime që i keni sot, kryesisht janë kapitale dhe po flas në emër të drejtorit mirë është t'a votojmë sepse këtu nuk kemi të bëjmë me politikë. Bëhet fjalë për një operator të suksesshëm që është fat që është nga komuna e Rahovecit dhe ndoshta pajisjet janë gati dhe i pret obligimet të cilat kishte mundur t'i merr edhe më herët në rast të mos krijimit të fondit rezervë, por ja që është krijuar ky fond dhe po thotë prej subvencionit vendose në kapital, e kemi gjetur kodin për bashkëfinancim dhe patjetër që bujqësisë duhet t'i japim krahë. Po flasim konkretisht "Haxhijaha Trade" ose djemtë e Halim Haxhijahës janë të përfshirë në dy kontrata për këto pagesa, nuk e kam për media por për asamblenë komunale. Pas fillimi të zbatimi të këtij udhëzimi administrativ shumë komuna kanë krijuar fond rezervë, ndoshta Bali Muharremaj e ka edhe 1.000.000, ka komuna që nuk kanë fare, por shumica po, kanë pas keq klasifikim. Ju ftoj për ta votuar, mos t'i vonojmë më shumë në ekzekutimin e pagesave.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, kryetari e përmendi që kur kemi ardhë te miratimi i buxhetit ne si opozitë e kemi pas këtë shqetësim, duke thënë se shikoni se këto janë subvencione-mallra shërbime etj... dhe keni qenë këmbëngulës që nuk janë, më në fund janë kthyer dhe tani si të doni quani, por në fakt i bie që këto asnjëherë nuk kanë qenë investime kapitale. Desha ta bëjë një pyetje çoftë për kryetarin ose drejtorin; po e lexoj saktësisht; ndërtimi i serave me participim 150.000eu, përkrahja me mekanizëm bujqësorë 150.000eu, stalla dhe ferma të vogla 50.000eu e tash me këtë të rejnë barten në kuadër të projekteve, përsëri po shkruan participimi me projekte në bashkëfinancim në bujqësi. Pata qejf për sqarim për çfarë projekte bëhet fjalë, nëse ka mundësi për elaborim, apo është i njëjti brumë. Pastaj desha të ndalem planifikimi urban, mjedis dhe inspektorati kodi funksional 0620, desha të pyes; hartimi i projekteve të ndryshme ka qenë 90.000eu plus 60.000eu prej të hyrave vetanake d.m.th. 150.000eu, faktikisht këto projekte po mbesin pa financim, çka po ndodh me "hartimin e projekteve" ku i marrim ato mjete? Sepse është ndryshim i madh.

Afrim Limani – Mësues, faleminderit shumë për pyetjen. Të njëjtën përgjigje e dhashë edhe më herët për Burimin, por tash dëshiroj t'a elaborojë më shumë. Pse janë bartë këto mjete në kuadër të projektit "Participimi në projekte me bashkëfinancim në bujqësi"? Për mendimin tim edhe ky projekt është si projektet tjera dhe do të duhet të ishte në keq klasifikim, por fatbardhësisht nuk është dhe është aktiv, përderisa është kështu serat dhe projektin tjetër ne po e bartim në kuadër të këtij projekti me mundësi që kemi të drejtë ligjore të bëjmë pagesën për këta operatorë. Ndërsa në planifikimet e vitit të ardhshëm nuk rrezikoj kështu, e kam përgatitur planin të cilin në qershor do ta keni në kuvend për votim me subvencione të rritura në kuadër të kësaj vlere në mënyrë t'i ikim keq klasifikimit duke zvogëluar investimet kapitale dhe rritur subvencionet. Te hartimi i projekteve – mbikëqyrja e projekteve jemi detyruar t'i vendosim në kategorinë mallra dhe shërbime, në këtë rast ne mund të operojmë me dy letra në mallra dhe shërbime dhe duke respektuar udhëzimin 04/2019 sepse aty shkruan: hartimi dhe mbikëqyrja e projekteve duhet të futet në kuadër të hartimit të atij projekti psh; ndërtimi i rrugëve lokale, operatori ekonomik e ka bërë hartimin e atij projekti dhe vlera hyn në kuadër të atij projekti, kurse ne për ta kryer obligimin financiar ndaj operatorit në fjalë, jemi detyruar që këto mjete t'i bartim në; rregullimin e shtretërve dhe lumenjve në komunën e Rahovecit. Ju lus për mirëkuptim sepse kemi kontrata dhe obligime për të gjitha këto projekte.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, atëherë propozimi i Leonard Morinës në emër të grupit të lëvizjes është që; prej kodit 47011 - 30.000eu të ndahen për subvencionim të sportit dhe 30.000eu për financim të teknologjisë nëpër shkolla. Propozimin si të tillë e vendosim në votim, nëse ka mospërputhje me ligj, këto mjete nuk vendosen aty ku propozohen. Propozimin po e vendosi në votim, kush është PËR këtë propozim të grupit të

lëvizjes Vetëvendosje? Kundër? Absteim? Me 15 vota kundër dhe 13 vota për nuk kalon propozimi i Leonard Morinës. Ndërsa Lirigzon Kastrati ka propozuar që disa mjete të shkojnë për çështje si më poshtë; 100.000eu për zgjerimin e ndriçimit publik si dhe 140.000eu për zonën ekonomike në Optrushë. Nëse ka mundësi Lirigzoni të na tregoj se ku t'i marrim mjetet?

Kryetari – 80.000eu për ndriçim publik i kemi vendos që e kemi fituar grantin e performancës, kontrata është duke shkuar drejtë përfundimit, nuk është e logjikshme të bartim mjete për diçka që është në përfundim e sipër. Ndërsa për zonën ekonomike në Optrushë, po iu siguroj që nuk mund të zhvillohet asnjë aktivitet, sepse procedurat e prokurimit duhet t'i nisë ministria e tregtisë industrisë ndërmarrësisë, ne jemi vetëm bashkë financues me 20%. Për zonë industriale ose ekonomike qeveria inicon procedurat, mos të ngutemi sepse nuk guxojmë të bëjmë asnjë hap për atë zonë, përderisa nuk na kanë dhënë dritën jeshile ministria e tregtisë industrisë dhe ndërmarrësisë dhe t'u kisha lutë t'i tërheqësh dy propozimet.

Lirigzon Kastrati – Përshëndetje kryesues, për mjetet e tërhequra ia lejmë në dorë drejtorisë së financave se ku dëshiron t'i merr këto mjete dhe kërkoj që propozimi të kaloj në votim!

Kryesuesi - Faleminderit Lirigzon, d.m.th 100.000eu janë kërkuar për zgjerimin e ndriçimit publik dhe 140.000eu për zonën ekonomike në Optrushë. Kush është PËR këtij propozimi? Kundër?... Abstenime nuk ka ... Kemi 15 vota kundër, 14 pro dhe propozimi i Lirigzon Kastratit nuk kalon. Propozimi i tretë Bejtullah Deliu ka propozuar që të shtohen 150.000-200.000eu për magazinimin e pemëve dhe perimeve në projektin e Komoreve ftohëse.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, vetëm po propozoj që këto mjete mundën të tërhiqen nga dy kode 66360 (planifikim urban dhe mjedis) dhe 40839 (hartimi i projekteve të ndryshme), por nëse kjo mund të interferoj keq në hartimin apo funksionimin e mirëfilltë të buxhetit mundemi edhe t'ia lejojmë në dorë drejtorisë së financave, por në këto dy kode është mirë të tërhiqen dhe është kërkesë eksplicite e imja.

Kryetari – Kodi është formuar, projekti është iniciuar, kuvendi i komunës ka vendos për një pjesë të mjeteve gjithashtu kryetari i komunës një pjesë të grantit e ka vendos për këtë depo mundem edhe të iu dokumentoj, por përderisa nuk e kemi ende projektin kryesor, sepse ka afat kohorë dhe ende nuk ia kemi nisur procedurës mendoj që 160.000eu janë aty kurdo që lidhet kontrata. Ne jemi duke shkuar kah fundi i vitit Bejtullah, imagjino ende nuk është bërë projekti kryesor e as procedura e prokurimit e me 160.000 për punë sivjet është tepër mirë. Në planin e buxhetit për vitin e ardhshëm ne i shtojmë mjetet dhe të kisha lutur të tërhiqesh sepse në depon për bujqësi do të jemi shumë mirë me financa edhe për këtë vit, prandaj kërkoj mirëkuptim sepse kodi dhe projekti ekzistojnë.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar. Bejtullah, propozimi qëndron ende?

Bejtullah Deliu – Shkojmë me votim, pasi u rrëzuan këta të tjerët, le të rrëzohet edhe i imi!

Kryesuesi – Atëherë po e vendosi në votim edhe propozimin e Bejtullah Deliu, kush është PËR?

Kundër?... Abstenim kemi?... Atëherë me 12 vota për, 14 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon propozimi i Bejtullah Deliu për ridestinimin e mjeteve. Po e vendosim këtë pikë të rendit të ditës si tërësi në votim, kush është për miratimin e kësaj pike të rendit të ditës? Kundër? Abstenim? Atëherë kemi 4 abstenime, 8 kundër dhe 15 pro, kështu miratohet shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale. Pauzë 5 minuta, rikthehemi. Vazhdojmë te pika e 4 e rendit të ditës aty ku edhe kemi mbetur shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e komiteteve për arsim dhe komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale, ndonjë prej ekzekutivit të na prezantoj këtë pikë..., atëherë Burim Krasniqi po e prezanton këtë pikë.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, meqenëse në KPF kam qenë propozues i kësaj edhe me kërkesën e ekzekutivit e arsyetoj. Arsyeja e themelimit të këtyre dy komiteteve është ajo sepse edhe si Burim edhe si LDK vlerësojmë që prej sektorëve kryesor në komunën e Rahovecit që ndërlidhen me pjesën e administratës janë shërbimet shëndetësore dhe arsimi. Si e tillë besoj që duhet të jenë dy komitetet dhe të themelohen si vendim me rekomandim me përfshirje të të gjitha subjekteve politike në këto dy komitete meqenëse janë katër.

Në parim nuk mendoj që komiteti të luaj rolin e hetuesit, por komiteti do ta luaj rolin t'i gjej lëshimet me qëllim të krijojmë në kualitet sa më të mirë në arsim dhe shëndetësi.

Kryesuesi – Faleminderit Burim. Atëherë po e vendosim në votim pikën e katërt të rendit të ditës, kush është PËR?... më shumicë unanime aprovohet vendimi për themelimin e komiteteve për arsim, për shëndetësi dhe për kujdesje sociale. Vazhdojmë te pika e 5 e rendit të ditës; Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e komitetit për arsim. Këtu janë gjithsej 5 anëtar, ku 4 delegohen prej kuvendit komunal dhe 1 ekspert i jashtëm me thirrje publike, që për këtë punë merret zyra ligjore apo sekretaria e kuvendit. Atëherë shkojmë me propozime duke filluar me grupin më të madh të asamblastëve, fjalën e ka Besë Bytyqi.

Besë Bytyqi - Faleminderit shumë kryesues, meqenëse sot Albani e ka ditëlindjen, atëherë në e propozojmë Alban Bajraktarin për këtë komitet.

Merisa Sharku – Përshëndetje për të gjithë, ne për këtë komitet e propozojmë Leonard Morinën.

Edona Kryeziu – Ne si grup i LDK-së, propozojmë zonjën Fahrije Lushi.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, ne e propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

Kryesuesi – Besoj që anëtarët e propozuar prej grupeve të asamblastëve nuk janë pjesë e komiteteve tjera, atëherë kemi 4 emra (anëtarët e komitetit për arsim) nga grupet e asamblastëve: Alban Bajraktari, Leonard Morina, Fahrije Lushi dhe Sejfullah Sejfullahu. Po vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet vendimi për përbërjen dhe organizimin e komitetit për arsim. Po vazhdojmë me pikën e 6-të, shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e komitetit për shëndetësi dhe për kujdesje sociale. Gjithashtu edhe ky komitet përbëhet prej 4 anëtarëve të kuvendit ku i ftojmë grupet e asamblastëve për propozimet, fjalën e ka grupi i Aleancës:

Besë Bytyqi – Përshëndetje, kësaj radhe nuk e kemi askënd me ditëlindje, e propozojmë Shukrije Himaj, e cila do të na bie një tortë.

Leonard Morina – Përshëndetje, faleminderit kryesues, propozojmë Vlora Vuçitërna.

Eqerem Spahiu – Faleminderit kryesues, ne si LDK e propozojmë Lirigzon Kastratin.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, për komitetin për shëndetësi dhe për kujdesje sociale e propozojmë Amir Vuçitërna.

Kryesuesi – Faleminderit atëherë është kompletuar edhe komiteti për shëndetësi dhe për kujdesje sociale gjithsej me 4 emra nga kuvendi komunal: Shukrije Himaj, Vlora Vuçitërna, Lirigzon Kastrati, Amir Vuçitërna. Po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet vendimi për përbërjen dhe organizimin e komitetit për shëndetësi dhe për kujdesje sociale. Vazhdojmë me pikën e 7-të: Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga komuna e Rahovecit, e ftoj drejtorin e kulturës z. Afrim Dina t'a prezantoj këtë pikë.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtor, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush kemi draft rregulloren për dhënien e titujve dhe dekoratave në komunën e Rahovecit e cila i ka munguar komunës tonë dhe për herë të parë hyn në proces që edhe komuna jonë të ketë një rregullore të tillë. Me datë 3 shkurt të vitit 2022 është formuar grupi punues nga kryetari i komunës. Gjatë takimeve ky grup punues ka shqyrtuar të gjitha format dhe të dhënat që komuna jonë të ketë këtë rregullore duke u konsultuar edhe me komunat e tjera që e kanë këtë rregullore. Draft rregullorja i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore, me datë 28.03 ka qenë në diskutim publik me çrrastë ka përmbushur afatin kohor ligjor, kurse me datë 12 prill kemi mbajtur takim publik me qytetarë në sallën e kuvendit ku kemi pranuar edhe komente të cilat i kemi implementuar në draft rregullore. Poashtu në mbledhjen e fundit të KPF-së, pasi që jemi trevë bujqësore, kemi pasur një propozim nga asamblasti Rumir Zhuniqi që në rregullore të përfshihet edhe çmimi “Bujku i vitit” të cilin hyjnë të gjithë; fermerët, bletarët etj... Në material i keni të gjitha të cekura, rregullorja përbëhet nga; Qytetar nderi, dekorata “Ukshin Hoti”, dekorata “Dr. Ali Sokoli”, medalja e lirisë, çmimi letrar “Sylejman Krasniqi”, çmimi “Bujku i vitit”, çmimi “Lexuesi i vitit”, medalja “Sportisti i vitit” dhe mirënjohje apo falënderime. Pas shqyrtimit kërkoj nga ju që t'a aprovoni, faleminderit shumë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, për këtë pikë të rendit të ditës hapet diskutimi, nëse ka dikush prej anëtarëve ndonjë propozim? Po, Bejtullah Deliu e ka fjalën.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues, faleminderit për shpjegime i nderuar drejtor. Është shumë e qëlluar që “Bujku i vitit” të përzgjidhet, kisha dashur të kemi mirëkuptim nga asamblistët dhe ta shtojmë edhe një pikë, si të cilësohet si çmim apo dekoratë, besoj që si dekoratë do të ishte më mirë, “Artisti i vitit”. Një elaborim të shkurtër pse po kërkojë një gjë të tillë: E kemi dëshmorin Avdullah Bugari që shumë kohë para luftës na ka argëtuar dhe gëzuar me humor, në atë kohë isha i vogël, por e përcjellja me vëmendje dhe më mbesin në kujtime pjesët humoristike të tij. Është fatkeqësi që në atë kohë nuk ka mundur të jetë aktor profesional, por është profesional me veprat që i ka lënë dhe është një ndër dëshmorët e parë që ka rënë (17 korrik) në ofensivën e Rahovecit. Nëse gjejmë mirëkuptim nga asamblistët kisha dashtë të kemi një dekoratë si “Artisti i vitit- Avdullah Bugari”. Faleminderit shumë, kërkoj përkrahje nga të gjithë.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, unë kam vetëm disa finesa të vogla të draft rregullorja. Te neni 4 pika 8, çmimi “Lexuesi i vitit” besoj që duhet të plotësohet, ku thotë; Çmimi lexuesi i vitit t’i jepet lexuesit-es banor i komunës së Rahovecit për numrin më të madh të librave të lexuara gjatë një vitit kalendarit i cili është anëtar i bibliotekës komunale “Sylejman Krasniqi” dhe bibliotekave tjera. Çmimi i rëndomtë jepet një herë në vit por jo domosdoshmërisht, këtë në fund është mire ta heqim, sepse është mirë ta lemë vetëm një herë në vit sepse numri i lexuesve po na bie vazhdimisht, e kjo “çdo vit” e bënë një garë ose nxitje për lexuesit. Dekorata për humanizëm dr. “Ali sokoli” neni 6 pika 4, mund të jetë pllakë metalike apo dekoratë në letër kartoni, këtu mendoj që duhet të specifikohet; duhet të jetë pllakë metalike, t’ia heqim këtë “apo”, ky është propozim i imi çështje tjetër është se si votohet nga delegatët e asamblesë komunale. Neni 7 besoj që duhet pak të riformulohet, thotë; pas aprovimit të rregulloret nga kuvendi i komunës për dhënien e dekoratave, kryetari i komunës ia adreson dekoratën solemn ish të dekoruarit. Kjo “pas” aprovimit nuk besoj që ka vend, por duhet të specifikohet dekoratat, medaljet, mirënjohjet i shpërndaj kryetari i komunës, jo “pas aprovimit” se kur të aprovohet kjo defakto me automatizëm kjo kalon, thjesht propozoj të riformulohet. Pika 3 neni 7 në rast se personaliteti nuk jeton, pranimin e dekoratës mund ta bëjë anëtar i afërm i familjes, apo personi i afërm i të dekoruarit, “jo mund ta bëjë” por e bënë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, do të ndalëm te neni 7 pika 3, sapo e përmendi i nderuari Burimi Krasniqi, këtu po propozoj kështu; në rast se personaliteti nuk jeton më, (presje) vazhdon fjalia... dekoratën mund t’a pranojë (jo, ta bëjë, dekorata pranohet) anëtar i afërm i familjes etj.. etj...Kjo nuk d.m.th. që është ashtu si po e them unë, në çoftëse nuk është kështu, nuk ia “prishi” askujt.

Kryetari – E dëgjova me vëmendje Bejtullah Deliu. Avdullah Bugarin, dëshmorin, unë personalisht e kam njohur kemi qenë bashkëveprimtarë në kuadër të lëvizjes popullore për republikën e Kosovës, jam dakord. Ekziston një situatë psh; janë vetëm çmimi “Sylejman Krasniqi” dhe çmimi “Ukshin Hoti”, ne i kemi mbi 120 dëshmorë duke menduar të bëjmë një zgjidhje të mirë që jam dakord, të hapim tema tjera për shkak të ndjeshmërisë, kualiteteve të dëshmorëve, heronjve etj.. d.m.th deri tani është vetëm Ukshin Hoti dhe Sylejman Krasniqi, nuk ka tjetër. Me këtë që po them, po e lus Bejtullahun që ne duhet të mendojmë ndoshta më ndryshe, e jo t’i fusim në rregullore çmime që sot i kemi dëshmorë. Paramendojeni në i kemi 5 heronjtë të shpallur në komunën tonë dhe 100 e sa dëshmorë dhe rregullorja ndoshta nuk ka mundësi t’i përfshijë të gjitha ato kualitete të veçanta që kanë mundur t’i kenë. Prandaj t’u kisha lutur me shumë respekt që nuk kisha pas dëshirë të jenë pjesë e rregullores sot, sepse standardi kryesisht është; qytetar nderi i komunës, në këtë rast ne e kemi themeluar medaljen Ukshin Hoti, çmimin letrar Sylejman Krasniqi, pastaj një figurë Ali Sokoli, që ka shkolla në Prishtinë me këtë emër, personalitet shumë i rëndësishëm, bujku i vitit shumë çmim i mirë, mund të jetë edhe artisti i vitit, por jo të jetë me emër dekorata, të kemi pak konsideratë sepse mund të kemi edhe fjalë të ndryshme, ku mbeti ky e ku mbeti ai?!! I kemi 120 edhe jam krenar që i kemi. Besoj që më kupton çka po them, kemi shumë, vetëm në Krushë janë 20, në fshat timin janë 5, në secilin fshat e në qytet janë 30, është pak problem të themelojmë medalje të veçantë me emër mbiemër. Medalje si artist ose humorist i vitit jemi

shumë në rregull nëpërmjet kësaj ne mund t'i shpjegojmë karakteristikat që filan dëshmorë ka pas këtë afinitet etj... po me ja vë emrin e veçantë së pari ty të del problem me disa tjerë, në kuptimin e asaj na keni harruar neve të tjerëve, ndoshta në situata të mëvonshme mund të gjejmë edhe ndonjë personalitet që kish me qenë më gjithëpërfshirës. Ali Sokolin edhe Ukshin Hotin e gjithë Kosova e njeh, si shkrimtar e patriot Sylejman Krasniqi të gjithë shqiptarët e njohin, janë tri personalitete që në një farë mënyre askush nuk kundërshton asgjë. Andaj iu kisha ftuar për miratim, me ndonjë korrigjim aty këtu, rregullore kjo që komunës tonë i ka munguar deri sot.

Bejtullah Deliu – Kryetar, me këto elaborime e sqarime nuk do mend që mundemi të mirëkuptohemi. Unë me artin emocionalisht jam i lidhur që në vegjëli dhe e kam përcjellë bukur shumë humorin e Avdullah Bugarit nuk është e rastësishme që e ceka si emër. Pajtohem me juve që mund të ngritët një paralele bukur e madhe sepse komuna jonë ka dëshmorë më së shumti në Kosovë dhe poashtu mund të jetë dikush i përafërt me aktivitetin e dëshmorit Avdullah Bugari, nëse kolegët e shohin që kjo mund të jetë një veprim jo i duhur që tjerët do të lëndohen, une nuk jam për t'i lënduar, por nëse nuk mund të emërtohet "Avdullah Bugari", së paku artisti i vitit duhet të figuroj sepse arti me ardhjen e juaj kryetar ka stagnuar, por duhet të gjallërohet pak.

Feriz Thaqi - Përsëritet kryesues, përsëritet kryetar, vetëm desha t'i tregoj Bejtullahut se në komunë i kemi 119 dëshmorë, në mesin e tyre janë 5-6 artistë edhe mirë është me ia dhënë çmimin e vitit një artisti, por jo me emra, të shkojmë me radhë kishte me qenë më mirë, faleminderit shumë.

Merisa Sharku – Përsëritet për të gjithë, rreth kësaj pike unë e kam një pyetje. Sigurisht që përzgjedhjen e këtyre personaliteteve e bënë një komision, kush e përzgjedh atë komision që e bënë përzgjedhjen e këtyre çmimeve?

Edona Kryeziu – Atëherë përsëritet për të gjithë, i nderuari kryesues, kryetar, ekzekutiv, drejtorë të drejtorive dhe të gjithë të tjerët që janë prezent në këtë seancë. Është e vërtetë ashtu siç e citoj edhe drejtori që draft rregulloren e kemi pas një kohë shumë të gjatë në dorë dhe e kemi lexuar mëse me vëmendje, e gjitha që më ka bërë përshtypje është që këtu nuk ceket askund që ekziston një kriter që duhet ta përmbush dikush përveç aplikimit. Në emër timin personal dhe në emër të grupit të asamblistëve të LDK-së, propozoj që të bëhet plotësimi ose të nxirret një rregullore që i përket kriterëve për aplikim, ose më konkretisht, si e bën përzgjedhjen komisioni për dhënien e titujve.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues, është mirë që u pajtuam për ndarjen e kësaj dekorate për artist, kolegja Merisa pyeti për komisionin, ndarsa siç e tha edhe Ferizi janë 5-6 artistë, dy prej tyre që janë dëshmorë profesor Muhamet Malësori dhe Avdullah Bugari me të cilët kam pasur fat të bashkëpunoj gjatë e gjatë e gjatë dhe për këtë arsye nuk e di si, por unë dua të jem patjetër në komision. E di kryetar që i keni njohur edhe ju, megjithatë më vije shumë mirë që është bërë kjo zgjidhje.

Kryetari – Faleminderit, unë jam dakord me atë që tha Bejtullahu, çmimi artisti i vitit. Ne kemi shumë shokë dëshmorë që janë artistë, i përmendi disa Sefa, disa Ferizi disa i din Bejta e disa të gjithë i dini. Jam dakord t'i nderojmë njerëzit me çmimin artisti i vitit, por pa emërtim. Ndërsa sa i përket kriterëve ato janë të përshkruara me rregullore p.sh: të marrim shembull çmimin Ukshin Hoti, një personalitet që i ka kontribuar vendit, çështjes kombëtare, me vlera, me integritet personal, qytetar, kombëtar etj.. mund të jetë i jashtëm dhe i brendshëm. Kush mund ta merr çmimin "Ali sokoli", një personalitet që i ka kontribuar po supozojmë çështjes kombëtare, por ndoshta edhe ndonjë profesionist apo mjek. Për shembull është nder që çmimin "Ali Sokoli" ta ketë Samedin Haxhijaha veç supozim dhe kot po flas, por ka kontribuar shumë në mjekësi dhe në çështje kombëtare. Cilat janë kriteret për qytetar nderi i komunës? Po zakonisht ai që ka kontribuar diçka për këtë komunë, që ia bie ndonjë donacion kësaj komune et.. mund të jenë edhe të komunës së Rahovecit po edhe jashtë saj.

Sejfullah Sejfullahu – Shumë shkurt kryetar, po insistoj te çmimi "Ukshin Hoti" prej kriterëve do të ishte mirë që fituesi i çmimit mos të jetë faktor politik apo që është i ndonjë subjekti politik.

Merisa Sharku – Për këtë arsye e kërkoja replikën, sepse nuk mora përgjigje se kush e krijon komisionin?!

Kryetari – Komisionin e krijon kryetari i komunës, normalisht që kryetari i komunës në diskrecionin e vet e ka edhe të ftoj edhe anëtarë të kuvendit të komunës.

Merisa Sharku – Kërkesa ime kish me qenë që këto komisione të krijohen prej kuvendit komunal dhe kur të bëhet ndarja e çmimeve le të jetë më gjithëpërfshirëse, do të bëhet përzgjedhje më e drejtë për mendimin tim, nëse në komision janë anëtarët e kuvendit.

Kryetari – Në këto raste të jemi të sinqertë që subjektet politike nuk është dashur të kenë peshë, por institucionet, gjithsesi raporti edhe kriteret bëhet në kuvend të komunës sepse nëse ndokush interesohet, atëherë kuvendi i komunës ka informata zyrtare dhe legale, por kryesisht kriteret fare nuk do të jenë politike. Ne do të kërkojmë ndihmën e kuvendit pas miratimit të rregullores sepse një figurë apo personalitet ka një konsensus të përgjithshëm është më mirë. Sigurisht komisioni ka punë të mundimshme sepse duhet të jetë përmbajtësor dhe duhet të ketë shumë të dhëna për një personalitet të rekomanduar për t'ia dhënë një çmim apo dekoratë të caktuar.

Merisa Sharku – Pikërisht për këtë arsye mendoj që nëse është gjithë përfshirja, atëherë nuk do të jetë politike, e nëse përfshihet vetëm një parti politike që jeni në pushtet në ndarje të çmimeve, atëherë është më shumë politike se sa nëse është gjithëpërfshirës komisioni.

Kryetar - Merisa, në raport me kuvendin e komunës së Rahovecit, unë operoj si kryetar i komunës. Në parti që jap çmim tjetër, Ramush Haradinaj e ka çmimin e vet. Ne po flasim si institucione, secili subjekt politik ka edhe dekorata e çmime të veta. Unë jam i obliguar të respektoj kriteret me një komision që vlerëson situatën, rekomandon dhe vendos.

Kryesuesi – Atëherë me propozimin e Bejtullah Deliut dhe me vërejtjen e Burim Krasniqit po e vendosim në votim miratimin e draft rregullores për dhënien e titujve të nderit, kush është PËR? Atëherë me shumicë unanime miratohet edhe draft rregullorja për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga komuna e Rahovecit. Kalojmë te pika e 8 e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të këshillit të fshatit Hoçë e madhe. Atëherë e ftoj anëtarin e kuvendit, njëkohësisht edhe kryetarin e komisionit ad hoc z.Lirigzon Kastrati ta prezantoj këtë pikë të rendit të ditës dhe të na raportoj për ecurinë e takimit të parë si komision.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, drejtorë, kolegë asamblistë. Më lejoni të iu njoftoj që komisioni ad hoc për përzgjedhjen për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe, sipas vendimit të kuvendit komunal nr.01299/2022 të datës 30 mars 2022 dhe në mbështetje të ligjit nr. 04L-62 për fshatin Hoçë e Madhe dhe udhëzimit administrativ të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor nr.11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe, komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve sipas ftesës publike të datës 11.03.2022 nr.283/2022 dhe në pajtim me nenin 4 dhe 7 të udhëzimit administrativ nr.11/2014, kuvendit komunal ia dorëzojmë listën e përzgjedhur të kandidatëve për votim. Siç e dini një anëtar i këshillit është nga kisha ortodokse, ai është Zvezdan Misic, kurse emrat e kandidatëve të përzgjedhur janë; Nahit Elshani, Munib Durguti, Kreshnik Haxhijaha, Mejreme Gërguri-Krasniqi, Miroslav Lukic, Aleksandër Misic dhe Bojana Kalamic. D.m.th kuvendi komunal do t'i përzgjedh 4 anëtarë, dy shqiptarë dhe dy nga komuniteti Serb.

Kryesuesi – Faleminderit Lirigzon, vetëm një plotësim edhe një emërohet nga kisha ortodokse nëse nuk gaboje sipas udhëzimit administrativ, atëherë meqë janë 7 emra, ka dikush ndonjë propozim- vërejtje rreth raportit të kryetarit të komisionit? Atëherë po vazhdojmë me votim, kuvendi duhet të vendos për anëtarët e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. I kemi me numër rendorë dhe kushdo prej kandidatëve që ka më shumë vota PËR bëhet anëtar i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Numri i parë; Nahit Elshani, kush është për?...kundër?...atëherë i kemi votat e barabarta me 15 vota për dhe 15 kundër, kuorumi është prej 30 anëtarëve të kuvendit. Po vazhdojmë edhe me anëtarë të tjerë dhe më pas përcaktuar siç po duket do të jetë kryesuesi i kuvendit dhe vendosi në fund. Numër dy; Munib Durguti, kush është për?...kundër?... kemi 13 vota për dhe 15 kundër për Munib Durgutin. Numër tre; Kreshnik Haxhijaha, kush është për?...kundër?... abstenim?... 15 vota për, 12

kundër për Kreshnik Haxhijahën. Mehreme Gërguri-Krasniqi, kush është për?... kundër?... Atëherë rezultati është ky; Nahit Elshani i ka 15 për, 15 kundër dhe një votë e imja shkon për si votë e dyfisht si kryesues i kuvendit. Munib Durguti i ka 13 vota për, 15 kundër. Kreshnik Haxhijaha ka 15 vota për, 12 kundër dhe Mehreme Gërguri- Krasniqi i ka 15 vota për 7 kundër. Atëherë kështu, prej katër kandidatëve shqiptarë për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe anëtarët e kuvendit kanë vendosë me këtë rezultat ku Nahit Elshani ka 15 vota për, 15 kundër? Sipas rregullores, kur votat janë të barabarta për çfarëdo votimi, kryesuesi e ka të drejtën e votës së dyfisht me çrast po e shfrytëzoj dhe po votoj për Nahit Elshanin, njëri prej anëtarëve të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Munib Durguti ka rezultat 13 për dhe 15 kundër, ka më pa vota se dy kandidatët tjerë shqiptarë dhe Munibi bie. Kreshnik Haxhijaha ka 15 vota për, 12 kundër dhe Mejreme Gërguri-Krasniqi ka 15 vota për, 7 kundër. Duke marr parasysh votat kundër në këta dy kandidatë, Mejreme Gërguri është anëtare tjetër e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Kështu kompletohet me dy anëtarë të shqiptarëve që e përbejnë këtë këshill. Ju kisha lutur për qetësi, për çfarëdo ankese që e keni, mund ta bëni në instancat që e përcaktojnë këtë punë. Sa për sqarim, disa gjëra nuk ka nevojë as për diskutim, Nahit Elshani nuk i ka 15 vota për, por 16. Atëherë po vazhdojmë përzgjedhjen edhe dy kandidatëve të komunitetit Serb; ... vazhdojmë me pauzë 5 minuta dhe rikthehem në sallë. Atëherë vazhdojmë duke iu lutur për qetësi, përshëndetje edhe një herë për të gjithë të nderuar anëtarë të kuvendit komunal. Kemi mbet te pika e 8 e rendit të ditës, para se të fillojmë me votimet e komunitetit Serb, si kryesues do ta dërgoj një shkresë në MAPL por edhe kështu publikisht për ata që e monitorojnë komunën e Rahovecit që ta shqyrtojnë situatën se si ka ndodhë votimi dhe te numri i votave që i kanë marrë kandidatët. Nëse pas monitorimit nga MAPL numri i votave nuk është në përputhje me numrin e votave me të cilin është marr vendimi, atëherë ky vendim do të kthehet në pikën zero në votimin e kandidatëve. Po fillojmë me votimin e kandidatëve të komunitetit Serb, me numër rendor 5, Miroslav Lukic, kush është për?...kush është kundër?...abstenim?... kandidati tjetër numër rendor 6, Aleksandër Micic, kush është për?... nuk ka vota për! kundër?... abstenim?...kandidati i tretë nga komuniteti serb, Bojana Kalamic, kush është për?...kundër?...abstenim? Atëherë me 12 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim Miroslav Lukic është njëri nga anëtarët e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe nga komuniteti serb. Aleksandër Micic, ka 0 vota për, 10 kundër, 1 abstenim dhe kandidati me numër rendor 7, Bojana Kalamic ka 6 vota për, 0 vota kundër, 4 abstenime. Pra, Miroslav Lukic dhe Bojana Kalamic janë dy anëtarë të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe nga komuniteti serb dhe po e vendosim në votim këshillin e fshatit Hoçë e Madhe me këtë përbërje, kush është për?...kundër?...abstenim?...me 16 vota për, 5 vota kundër dhe 1 abstenim, miratohet edhe pika e 8 e rendit të ditës. Kalojmë te pika e 9-të; Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.296/2022 i datës 30.03. 2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe pika e 10-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.295 për 22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak. E ftoj drejtorin Afrim Oruqi që t'i prezantoj këto dy pika të rendit të ditës.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush në bazë të ligjeve të republikës së Kosovës, kemi vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.019 nr.296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit në fshatin Hoçë e Vogël, me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi nr.01 numër 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut në fshat. Ky ndryshim ka ardhë si pasojë e rekomandimit nga ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe nga MAPL pas nenin 3 të vendimit bazik 01/296-22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për morg, pason pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 5 ari e 500 m katror, në të cilën parashihen që të ndërtohen morgu. Kërkesë e këtyre dy ministrive ka qenë që në vendim të parashihet edhe se si është e destinuar kjo parcelë sipas planit zhvillimor komunal. Ju ftoj që pas shqyrtimit të votoni propozim vendimin me ndryshim për ndërtimin e morgut në zonën kadastrale Hoçë e Vogël. Të nderuar anëtar të KPF-së para jush kemi vendimin për ndryshim dhe plotësimin e vendimit 019/295-22 i datës

30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak. Gjithashtu këtë vendim e kemi pasur muajin e kaluar, mirëpo pas rekomandimeve të ministrisë së mjedisit dhe MAPL-së të cilët kanë kërkuar që në vendim të parashihet edhe sipas planit zhvillimor komunal se kjo parcelë të ndahet dhe ndërtohet ashtu si parashihet, pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 3 ari, në të cilën parashihet të ndërtohet objekti sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi sipas PZHK-së komunale me nr. 01/2566 i datës 30.05.2013 që gjendet brenda zonës ndërtimore. Ftoj anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të votojnë propozim vendim ndryshimin për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit në fshatin Çifllak.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, dikush prej anëtarëve të kuvendit në lidhje me këto dy pika?...Nëse jo, atëherë ... po, Lirigzon Kastrati e ka fjalën.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, atëherë këto dy pika të rendit të ditës kanë kaluar në seancat e kaluara, kështu që jemi pro në emër të grupit.

Kryesuesi – Faleminderit Lirigzon, atëherë po e vendosim në votim fillimisht pikën e 9 të rendit të ditës, kush është për? Me shumicë unanime aprovohet edhe plotësim ndryshimi i vendimit 296/22 dhe kështu përfundon pika e 9-të e rendit të ditës, vazhdojmë me votim për pikën e 10-të, kush është për?... me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 10-të e rendit të ditës, vazhdojmë te pika e 11-të; Raporti vjetor i punës së komitetit të auditimit për vitin 2021, e ftojme kryesuesi e komitetit për prezantim të raportit.

Sead Rama – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë asamblastët. Raporti vjetor i punës së komitetit të auditimit për vitin 2021, komiteti i auditimit ka shqyrtuar raportet auditimit të brendshëm dhe raportin vjetor të auditorit gjeneral për vitin 2020, gjithashtu komiteti i auditimit ka mbajtur 5 seanca ku janë shqyrtuar pika të ndryshme sipas programit dhe planit të punës për vitin 2021. Seanca e parë ka qenë shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020, shqyrtimi dhe aprovimit i draft statusit të komitetit të auditimit të brendshëm si dhe të ndryshme. Seanca e dytë; shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për drejtori për administratë të përgjithshme, shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për drejtori, shëndetësi dhe përkujdesje sociale. Seanca e tretë; shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2020, shqyrtimi i raportit final të zyrës së prokurimit dhe shqyrtimi i raportit të drejtorisë për inspektim. Seanca e katërt; shqyrtimi i raportit të brendshëm për zyrën e prokurimit, shqyrtimi i raportit të brendshëm për drejtori për inspektim. shqyrtimi i raportit të brendshëm për drejtori komunale të arsimit. Seanca e pestë; shqyrtimi i raportit të brendshëm për drejtori kadastrë, gjeodezi dhe tatim në pronë, shqyrtimi i raportit të brendshëm për drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe të ndryshme. Janë dhënë shumë rekomandime me të cilat si komitet i auditimit kemi participuar në performancë, nëse keni ndonjë pyetje?

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, përshëndetje për drejtorët, kolegët, përfaqësuesit e këtij komiteti. Fillimisht më lejoni të iu njoftoj se cilat udhëzime - ligje e rregullojnë këtë komitet. Ligji nr.06L021 për kontrollin e brendshëm të financave publike neni 20 e përcakton punën e komitetit të auditimit. Udhëzimi administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 7 janë përgjegjësitë e komitetit të auditimit, neni 10 e kemi raportin vjetor të komitetit të auditimit. Ne e kemi pranuar një raport aty është një përmbledhje e procesverbaleve, mirëpo si grup i asamblastëve i kemi edhe disa rekomandime; ligji mbi auditorin e brendshëm jep komitetit të auditimit autoritetin dhe përgjegjësinë si në vijim; siguroj se menaxhmenti i lartë dhe personeli i sektorit publik zbatoi në kohë rekomandimet e bëra nga njësia e auditimit të brendshëm, lejojnë që njësia për auditim të brendshëm të vlerësoj shkallën deri ku janë zbatuar rekomandimet e mëhershme dhe shkallën e ndonjë përmirësimi që ka rezultuar. Ne e kemi një raport të vitit 2020 të auditorit të jashtëm, aty janë disa rekomandime, kërkoj nga përfaqësuesi të na tregoj për rekomandimet që janë zbatuar dhe që janë përfunduar nga komiteti i auditimit. Një vështrim i shkurtër në raportin e komitetit të auditimit, raporti i komitetit të auditimit për vitin 2021 ka disa mangësi të cilat duhet t'i prezantojmë para kuvendit komunal. Mangësitë e vërejtura në raport janë si në vijim; Këtij raporti i mungon përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi të komitetit të auditimit si

organ këshillëdhënës për mbikëqyrjen e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Raporti është një përmbledhje takimesh të komitetit ku bën përshkrimin e raportit të auditorit të brendshëm sipas drejtorive, formati i raportimit ka dizajn të koklavitur, i cili nuk ia mundëson kuvendarëve të kenë një pasqyrë të qartë lidhur me ecurinë e menaxhimit të parasë publike dhe pasurisë publike. Raporti nuk ka të nxjerra dhe përfundime lidhur me; vlerësimet e tij për kontrollin e brendshëm, sfidat, punën e njësisë së auditimit të brendshëm, pengesat dhe të arriturat në zbatimin e rekomandimeve. Si grup i asamblistëve rekomandojmë; në raport të prezantohet qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit të auditimit, të hartohet një format i raportimit i cili duhet të jetë i qartë dhe informues për anëtarët e kuvendit komunal, raporti në fund të ketë konkluzione dhe rekomandime që ka vërejtur në vitin fiskal për të cilat duhet të ketë njoftime menaxhmenti i lartë, në këtë rast kuvendi komunal.

Sead Rama – Sa i përket raportit që është mbajtur në formë të procesverbalit, ne jemi si rekomandues, thjesht nuk marrim vendime, janë auditorët e brendshëm të cilët marrin vendime dhe shumë pika që sipas juve nuk janë bartë e sqaruar aty, janë zgjidhur dhe përmirësuar siç shihet edhe në raportin kryesor të auditorit të jashtëm që çdo vit ka përmirësime.

Rasim Fazliu – E gjitha që tha Lirigzoni, e pranoj d.m.th. ashtu është dhe desha të solidarizohem me të. Të nderuar, në seancën e parë, pika 2 shkruan; shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020, në fakt asgjë nuk shkruan për këtë pikë këtu! Nuk dua të marr kohë e të lexoj, por asgjë hiç, zero. Në fakt komiteti i auditimit duhet t'i paraqes këtu disa të dhëna, sa rekomandime janë shqyrtuar, ku janë ato vërejtje, çka është bërë - tek është bërë, të na bëjë publike këtu, e në fakt në letër ne si anëtar të kuvendit nuk kemi asgjë absolutisht. Për më mirë do të ishte kështu; raporti i auditimit të brendshëm të vije në kuvend, ligji e thotë që ata i japin llogari kryetarit të komunës, shumë e qartë kjo, por kryetari i komunës ka mundësi të na sjellë neve këtu informacione dhe ne ta shqyrtojmë raportin si tërësi se si e ka bërë auditori i brendshëm, e ne ta lexojmë, diskutojmë, kontribuojmë, shqyrtojmë etj.. e kjo nuk po ndodh, ndërsa ju si komitet i auditimit vetëm jeni takuar dhe nuk keni bërë asgjë, ndoshta edhe keni diskutuar, por këtu në letër nuk po thotë asgjë. Tjetra, kur e kthejmë logjikën prapa, jemi në vitin 2022, çfarë logjike është që ne të flasim për vitin 2020 sepse raporti i auditimit të brendshëm duhet të shqyrtohet gjithmonë para auditimit të jashtëm, thjesht diskutimi i bërë duhet të vendoset në letër dhe më pastaj hapet diskutimi dhe kemi çka të flasim, nuk do të thotë të vendosim vetëm vërejtje, ka edhe shumë gjera të mira, mos më keqkuptoni. Faleminderit shumë.

Sead Rama – Faleminderit për këshillën. Në të ardhmen do të zbatohen këto, sepse ne i kemi procesverbalet dhe të gjitha që i kemi diskutuar. Raporti vjetor i auditorit gjeneral për vitin 2020, diskutohet në vitin 2021 sepse ata e sjellin me vonesë, çdo herë një vit mbrapa është, sa për sqarim. Faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit për sqarimet, kështu po kalojmë te pika e 12-të e rendit të ditës; Projektvendimi për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese, poashtu edhe pika e 13-të e rendit të ditës është projektvendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën 02756-0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe. E ftoj drejtorin e ekonomisë për prezantimin e këtyre dy pikave të rendit të ditës.

Erhan Morina – I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtarë të kuvendit, media dhe ju të pranishëm. Para jush keni materialin që bëhet fjalë për dy parcelat të cilat gjenden në Krushë të Madhe, bëhet fjalë për parcelën me nr. të certifikatës së pronësisë 01704-0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe në vendin e quajtur “Rasa sprud” me sipërfaqe 143.712 metra katror dhe parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 02745-0 me sipërfaqe 381.960 metra katror, të cilat poashtu gjenden në Krushë të Madhe në vendin e quajtur “Rasa sprud”. Këto dy parcela janë pronë e komunës të cilat drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm dëshiron t'i destinonë si hapësira për biznese, gjithmonë në funksion të krijimit të kushteve sa më të favorshme për bizneset që operojnë në komunën tonë. Vlenë të cekët se këto parcela janë të komunës së Rahovecit dhe nuk ndërron titullari juridik, pronari i tyre mbetet kuvendi komunal i Rahovecit, prandaj ftoj anëtarët e kuvendit komunal që të votojnë këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit... Edhe këtë herë e keni materialin për parcelën me nr. të certifikatës së pronësisë 02756-0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe në vendin e quajtur “Paca Paca” me sipërfaqe 197.647m katror. Kjo parcelë është nën menaxhimin e

agjencionit të ujërave dhe të njëjtën pronë e shpallim me interes të përgjithshëm me qëllim që në seancën e radhës edhe kjo parcelë të destinohet si hapësirë për biznese, në material i keni të bashkangjitura edhe fotot, ftoj anëtarët e kuvendit komunal që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, para se t'i vendosim në votim këto dy pika të rendit të ditës, dikush ndonjë diskutim në lidhje me këto?...Atëherë në votim po e vendosim pikën e 12-të të rendit të ditës; projektvendimi për caktimin e lokacionit për hapësira për biznese, kush është për?...kundër?...abstenim?...Atëherë me 12 vota për, pa votë kundër dhe me 2 abstenime, kalon projektvendimi për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese. Vazhdojmë me pikën e 13-të të rendit të ditës; shpallja me interes të përgjithshëm publik parcelën 02756-0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe, kush është për?...kundër?...abstenim?...Atëherë me 13 vota për, pa votë kundër dhe 2 abstenime miratohet edhe projektvendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës në fjalë. Kalojmë te pika e 14 e rendit të ditës; plotësim ndryshimi i vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit të miratuar nga kuvendi komunal në seancën e kaluar, kush është për?...Me shumicë unanime të votave miratohet edhe propozimi për plotësim ndryshimin për komisionin për emërtimin edhe riemërtimin e rrugëve.

Besë Bytyqi – Faleminderit shumë dhe kërkoj ndjesë që po e marr edhe një min.. kohë. Duke parë që shumë prej kolegëve asamblastë nuk janë këtu në këto pika shumë të rëndësishme të rendit të ditës, në mandatin e kaluar e kemi pas edhe në fillim të seancës edhe në fund të saj të nënshkruhemi, kërkoj nga zyra e kuvendit që të na bie listën e nënshkrimeve në fund të seancës sepse nuk është në rregull që këtu të jemi 15 ose 16, kemi kuorum por nëse 10-të asamblastë kanë dalë edhe nuk janë këtu, atëherë nuk është në rregull. Shumë faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë për kritikën, besoj që kjo çështje do të rregullohet prej seancës së ardhme, deri në seancën tjetër të rregullt, mirë mbetshi.

Mbledhja përfundoj në 16:20

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Defrim Kafexhiu



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2259/22 i datës 10.06.2022 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01038-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1231m² (njëmijë e dyqind e tridhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.2.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01055-2 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skaja, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 362m² (treqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.3.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01034-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 549m² (pesëqind e dyzet e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.4.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01045-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4138m² (katërmijë e njëqind e tridhjetë e tetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.5.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01033-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej

2162m² (dymijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.6.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01044-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2142m² (dymijë e njëqind e dyzet e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.7.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01040-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1491m² (njëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e një metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 400m² (katërqind metrakatror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.8.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01036-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Suga-kod puta, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2445m² (dymijë e katërqind e dyzet e pesë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1700m² (njëmijë e shtatëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Parcelat e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Me datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahoval/Municipality Orahoval
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAL/MUNICIPALITY ORAHOVAL
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRIDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit te Komunës)
Nr./Br./No 2259 Nr. i faq/Br.str/No pg 389
Data/Datum/Date 10 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAL

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi janë:
 - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01038-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1231m² (njëmijë e dyqind e tridhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01055-2 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skaja, me kulturë Kullosë e Klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 362m² (treqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01034-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 549m² (pesëqind e dyzet e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01045-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4138m² (katërmijë e njëqind e tridhjetë e tetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.5. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01033-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej

2162m² (dymijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.6.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01044-0 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2142m² (dymijë e njëqind e dyzet e dy metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit

2.7.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01040-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skeja, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1491m² (njëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e një metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 400m² (katërqind metrakatror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;

2.8.Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01036-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Suga-kod puta, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2445m² (dymijë e katërqind e dyzet e pesë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1700m² (njëmijë e shtatëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
5. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa Komunale në bazë mujore.
6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme
7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

Me propozim të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01038-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027729/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	09.06.2022 - 11:38
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Xërë / Zrë / Xërë
Zyrtar Kadastrale Komunal / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Superfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510033-01038-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		1231			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SKEJA-				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Ibroj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Byqësori/Pojopritvredie/Agriculture	Arat/Njive Arable	Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land	1231

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postai Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidm individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	680515233	RAHOVEC/ ORAHOVAC/ RAHOVEC/		DËSHMORËT E PASHTRIKUT	1/1		




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-71510033-01038-2	Parcelë / Parcela / Parcel	1231



Shkalla/Razmera/Scale: 1:428

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 09.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:41:56

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01055-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027628/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	09.06.2022 - 09:27
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Xërxë / Zrce / Xërxë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71510033-01055-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		362	6-1994		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
SKAJA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Bros Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Polljoptivrcine/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë I: Klasës 2/Pashnjak 2 Klasë 2nd Class Pasture	362

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidin individual / Indivudualna Dpravina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHIMORËT E PASHTRIKUT	1/1	6-1994	






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510033-01055-2	Parcelë / Parcela / Parcel	362



Shkalla/Razmera/Scale: 1:228

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 09.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:21:23

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Aprovqi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01034-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027628/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	09.06.2022 - 09:26
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Xërxë / Zrze / Xërxë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azuritano Updated
P-71510033-01034-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		549			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvana Called place	Kodi Postai Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azuritano Updated
SKELA-				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenjeja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenjeja parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqesore/Poljoprivredno/Agriculture	Arai/Njive/Arable	Artë E Klasës 3 Njyra 3 Klase 3rd Class Arable Land	549

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkritimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	680535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHMORET E PASITRIKUT	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510033-01034-0	Parcelë / Parcela / Parcel	549



Shkalla/Razmera/Scale: 1:325

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 09.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 09:32:16

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoj/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živine Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01045-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0027527/22
Data dhe koha e tësimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.06.2022 - 14:36
Komuna / Opština / Municipality: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë / Zrze / Xërxë
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510033-01045-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shqiptare / Društvena Imovina / Socially owned Land		4138			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualifur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SKEMA-				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëqesore Poljoprivredno / Agriculture	Arazi/Njive /Arable	Artë I: Klases 3 Nivja 3 Klase 3rd Class Arable Land	4138

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postai Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Ideo imovine Share quanta	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	640535233	RAHOVECI / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DESMORETTE PASITRIKIT	1/1		






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510033-01045-0	Parcelë / Parcela / Parcel	4138



Shkalla/Razmera/Scale: 1:705

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 02:40:54

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Approvoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Transportit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živote Sredine, Prostonog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01033-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0027343/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.06.2022 - 08.37
Komuna / Opština / Municipality: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone: Xërxë / Zrze / Xërxë
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510033-01033-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Imovina / Socially owned Land		2162			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitetit Mesto znanje Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SKEJA-SKEJAJ Drejtë Komunitetit Drejtë Komuniteta				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Brot Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujëçesore Poljopivrcdno Agriculture	Arat Njwe Arable	Arë E Klases 3 Njwa 3 Klase 3rd Class Arable Laid	2162

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Idea imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHMORET E PASHTRIKUT	1/1		





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510033-01033-2	Parcelë / Parcela / Parcel	2162



Shkalla/Razmera/Scale: 1:620



Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:02:39

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Data/ Data/Date: 08.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 09:48:59

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/22 i datës 00.00.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01043-1, P-71510033-01035-0, P-71510033-01039-0 dhe P-71510033-01036-2.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga AAK;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga LVV;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga LDK;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga PDK;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. ____/22
Datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/22 i datës 00.00.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510057-01830-0.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga AAK;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga LVV;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga LDK;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga PDK;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), nenit 25 dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 dhe nenit 32 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror

1. **Miratohet** propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/2251/22 i datës 09.06.2022 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Rezine zonë kadastrale Pastasellë, ngastra me numër P-71510066-00944-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 3321m² (tremijë e treqind e njëzet e një metra katror) **I JEPET** Ekonomisë së Pyjeve, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510066-00386-1 në emër të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) i muret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) dhe **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e Ekonomisë së Pyjeve të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. Parcela me Nr. P-71510066-386-1 në të cilën parashihet ndërtimi i objektit sipas pikës 2 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 ka destinim 40% në Zonë Ndërtimore kurse pjesa tjetër është në Zënën e tokës Bujqësore klasa e bonitetit III.

4. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës së Ekonomisë së Pyjeve të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
6. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyer, si dhe emrin e pronarit të institucionit me të cilin është bërë këmbimi.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC


01-Nr ____/22
Me datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 24, nenit 25 paragrafi 4, 5 dhe 6 dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 29, nenit 31 dhe nenit 32 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhënien e PËLQIMIT për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Rezine zonë kadastrale Pastasellë, ngastra me numër P-71510066-00944-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 3321m² (tremijë e treqind e njëzet e një metra katror) I JEPET Ekonomisë së Pyjeve, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510066-00386-1 në emër të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) i muret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) dhe I JEPET Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi është për interes publik, përkatësisht për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 24, 25 dhe 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 29, 31 dhe 32 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave e provave të këmbyer, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
2. Sekretarisë së Kuvendit dhe
3. Arkivit.





Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.03.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1666/22, i dt. 09.03.2022 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte-Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve, Rahovec.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit", i cili do të shërbejë për aktivitete kulturore sportive për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjërë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.293/22
Datë:30.03.2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES	
Njësia Nr./Br./No	02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No	1466 Nr i fag/Br.sq/No.pg 331
Data/Datum/Date	9.3.27
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON


Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon inicimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte-Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë, në posedim si pasuri shtetërore e Kosovës, K.K.Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë "Caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit", e cila do të shërbejë për aktivitetet kulturore sportive për qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.





CERTIFIKATĚ / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJEŠIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510066-00386-1

Numri lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/03-0011294/22

Data dhe koha e kështimit / Datum i vreme tshvuvnja / Date and time of submission:

08.03.2022 - 08.31

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cudinstal Zone:

RAIOVIC / ORAIJOVIC / RAIJOVIC
Paliselle / Pusto Selo / Pustiselle

Zyrya Kulasturule Komenenale / Opštinsku Kulastursku Kanceluriju / Municipal Cultural Office: RALIOVEC / OKALIOVAC / RALIOVHC;

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

[illegible]

Printed by Offshoots of the Press, Ltd., 15, Abchurch Lane, London, E.C. 4, England.

Zyrtari përfjale / Oddvornio lte / Oficial person

A.2.LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Vremutin koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²) (m²)
1	Take Ndërtimore/Grafiçevriska zemljijstic/Construction land	Obor/Dvoriste/Back yard		21540
2	Take Ndërtimore/Grafiçevriska zemljijstic/Construction land	Shtëpi-Muqetesca/Kuca-Zgrada/House-Building		465

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Residenti	Kodit postar Poštanski kod Postal code	Hollcajlic e adresës Opštinski adresic Address details	Pjesa e pronës Udeo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirani Updated
Posedim individual/ Indivodualan Drzavna Single possessor	PASURI SHETEJE KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKO.E PYJEVE RAHOVEC	KC/DJ1505767	RAHOVIC/ ORAHOVAC/ RAHOVEC/		RAHOVEC	1/1	1-2004	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pastasellë

Nësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510066-00386-1	Parcelë / Parcela / Parcel	22005



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1529

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.03.2022

Koha/ Vreme/ Time: 08:38:37

Nënshkrimi/Polpis/Signature:

Shënimi/Beleška/Note:



Approvimi/Svojio/Approved:

Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Polpis/Signature:



Skica e tereni

Z.K. Pastasel

P/1:1000

Parc. nr. 386-1

386-3

Rrugë 386-2

Pjesa e parc. nr. 386-1
në sipërfaqe 1000m²



Rahovec me 08.03. 2022

Miftar Krasniqi gjeom.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510066-00944-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027736/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:	09.06.2022 - 11:35
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Pastaselle / Pusto Selo / Pustoselle
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Supërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510066-00944-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		3321			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitet Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
REZINE-REZINE				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
I	Bujqësori/Poljoprivredno Agriculture	Arat/Njive Arable	Arë E Klasës 5/Njiva 5 Klasse/5th Class Arable Land	3321

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebysaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600335233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHIMORËT E PASITRIKUT	1/1		





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu


Department of Cadastre



Skica e terrenit

Z.K. Pastasel

P/1:500



Rahovec me 07.06. 2022



Miftar Krasniqi gjeom.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pastasellë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-71510066-00944-0	Parcelë / Parcela / Parcel	3321



Shkalla/Razmera/Scale; 1:673



Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 09.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:38:31

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovui/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

944-0 2-K. PASTASELLE





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odhëjënje za Opštu Upravu

-111-

Nr. l prot.

487

Më

14.02.2022

Br. prot.

RAHOVEC - ORAHOVAC

Kërkesë

PËR: Kryetarin e Komunës Smajl Latifi.

NGA: Jeton Krasniqi, Kryetar i Këshillit të Kryesisë së fshatit Pastasellë.

Tema: Kërkesë për përfshirjen në rend dite dhënien në shfrytëzim të një pjese të pronës publike.

I nderuar,

Kryesia e këshillit të fshatit Pastasellë, kerkon nga Kryetari i Komunës, që këtë muaj, të përfshijë në rend dite këtë pike:

1. Dhënien në shfrytëzim të një pjese të pronës publike, me nr. P-71510066-00386-1, pranë varrezave të fshatit.

Arsyeja: Ndertimi i një shtepie për nevoja të fshatit.

Shpresojmë që kërkesa jonë të aprovohet.

Me respekt: Jeton Krasniqi.

Tel: 044-623-849

14.02.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

III- Nr. i prot. 2123 Më 13.06.2022
Br. prot. Dt. 2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	13.06.2022
Për/Za/To:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Arben Gashi, Kryesues i Komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim
Lënda/Predmet/Subject:	Raport

Në bazë të vendimit të kryetarit 01/386/22 të datës 07.06.2022 për caktimin e komisionit për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit, komisioni i përbërë: Arben Gashi, Miftar Krasniqi dhe Ekrem Bytyqi.

Komisioni ka mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim në komunën e Rahovecit. Me 13.06.2022, komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka bërë vlerësimin e dy parcelave në zonën kadastrale në fshatin Pastasellë, pronë e komunës së Rahovecit dhe Pasuria Shtetërore e Kosovës KK.Rahovec, e Shfrytëzuar nga Ekonomia e Pyjeve në Rahovec në zonën kadastrale në fshatin Pastasellë. Duke u bazuar në neni 24 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Komisioni ka bërë vlerësimin se prona komunale që do jepen në këmbim, ka këto karakteristika: parcela në zonën kadastrale në fshatin Pastasellë, me sipërfaqe të përgjithshme 3321m² Certifikata P-7150066-00944-0 pronë e komunës së Rahovecit, të ndahet pjesa e kësaj sipërfaqe prej 1000m² dhe ti jepet Ekonomisë së Pyjeve. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është: parcela kadastrale në fshatin Pastasellë me sipërfaqe 22005m² Certifikata e pronësisë P- 71510066-00386-1, në emër të Pasurisë Shtetërore të Kosovës, shfrytëzuese Ekonomia e Pyjeve në Rahovec, të ndahet pjesa e parceles në sipërfaqe prej 1000m² dhe ti jepet Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për “Caktimin e lokaconit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit”, në Zonën Kadastrale në Pastasellë.

Komisioni për Vlerësimin e pronës Komunale për këmbim, ka vlerësuar së këmbimi i pronave të Paluajtëshme duhet të bëhet pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për “Caktimin e lokaconit për ndërtimin e objektit për aktivitete kulturore-sportive për nevojat e komunitetit”, i cili do të shërbejë për aktivitetet kulturore sportive për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.


Bazuar në gjendje faktike në teren nga komisioni për Vlerësimin e Pronës Komunale për Këmbim, ka konstatuar se është sipërfaqe e përshtatshme ku do të bëhet “Caktimi i lokaconit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit” në Pastasellë.

Komisioni:


Arben Gashi, Kryesues



Miftar Krasniqi, anëtar



Ekrem Bytyqi, anëtar





Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Numër: I protoklit / Data	457 / 14.02.2022
Data:	09.06.2022
Për:	Këshillin e fshatit Pastasellë
Nga:	Drejtoria për Urbanizm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit
Përmes	Drejtorit të drejtorisë Albnor Mullabazi
Lënda / subjekti	Vërtetim Urbanistik
Baza:	Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative

Bazuar në kërkesën e Këshillit të fshatit Pastasellë nr. protokolit 457 të datës 14.02.2022, për verifikimin e destinimit të parcelave kadastrale sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) që është në fuqi.

1. Ngastra kadastrale Nr. P-71510066-00386-I, Vendi i quajtur Seishte - Seishte, me sipërfaqe 22005 m², pronar PASURI SHTET.E. KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY. EKO. E PYJEVE RAHOVEC z.k. Pastasellë.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lëndës dhe shkresat e lëndës suaj ka konstatuar se:

Ngastrat kadastrale me Nr. P-71510066-00386-I, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë është diku **40% në Zonë Ndërtimore** kurse pjesa tjetër është **në Zonën e tokës Bujqësore Klasa e Bonitetit III.**
Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

Pëlqimi ti dërgohet :

1. *Palës*
2. *Arkivit të Drejtorisë.*



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1

1. **Miratohet** vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe Qarkorja Buxhetore 2023/1.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01/Nr. ____/22
Me datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Oraovac / Municipality of Rahovec



K O R N I Z A A F A T M E S M E
B U X H E T O R E (K A B)
E K O M U N Ě S S Ě R A H O V E C I T
2023-2025

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2022

Përmbajtja:


Përmbajtja:	1
I. Hyrje	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:	6
2. Forcimi i sektorit të bujqësisë	6
2.1 Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor, duke i klasifikuar për secilin sektor si:	7
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim	8
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve	9
1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale	10
2. Administratë e Përgjithshme	12
3. Rinia, kultura dhe sporti	12
III. Korniza Fiskale Komunale	13
3.1 Indikatorët ekonomik komunal	13
3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2023-2025	14
3.3 Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2023-2025	18
3.4 Analiza Gjimore	25

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave, prioritetëve, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2023/01, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2023-2025. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:





III

Publikimi i Dokumentit të KAB-it 2023-2025

Fundi i Qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2023

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime të vogla dhe një qendër urbane e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 2602 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale, që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të Komunës dhe 8 të tjera në fshatra, gjithashtu Komuna e Rahovecit posedon edhe E-kioskun, një mundësi e mirë që qytetarëve ju mundëson vetë-shërbimin me dokumente administrative (certifikata të ndryshme).

Vizioni i mëposhtëm për komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjatë strategjike që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2023-2025 (I), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i komunës së Rahovecit është: **"Të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, arsimit dhe jetës sportive. Po ashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj".**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti, llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dytributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

PRIORITETET:

- BUJQËSIA;
- EKONOMIA;
- AGROTURIZMI DHE PUNËSIMI;
- ADMINISTRATË BASHKËKOHORE ME SHËRBIME TË SHPEJTA DHE CILËSORE;
- ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE;
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE TË RREGULLUAR DHE TË MIRËMBAJTUR;
- INVESTIME NGA FONDI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT;
- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË SI DHE RRIJTJA E PËRKRAHJES PËR KËTA SEKTORË;
- PROMOVIMI I POTENCIALIT DHE MUNDËSIVE PËR INVESTIME NGA MËRGATA JONË;
- TRASHËGIMIA KULTURORE, HISTORIKE DHE INVESTIME PËR TA NDERUAR HARTËN E SAKRIFICËS DHE LIRISË.

ZOTIMET:

- KOMUNË E HAPUR PËR QYTETARËT - TRANSPARENCË E PLOTË DHE LLOGARIDHËNIE;
- KOMUNË QË QEVERISËT DREJTË DHE MIRË, LIGJSHËM DHE ME PERFORMANCË TË LARTË;
- KOMUNË KU JU SHËRBEHET QYTETARËVE PA DALIM;
- KOMUNË ME SHËRBIME GJITHNJË E MË BASHKËKOHORE;
- KOMUNË KU PROMOVHEN POLITIKAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA SI DHE STANDARDET E LARTA TË QEVERISJES;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT NJERËZORE E QYTETARE;
- KOMUNË PA DISKRIMINIM E QË QYTETARËT I TRAJTON BARABARTË;

- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT KOMBËTARE, HISTORIKE, VLERAT E LUFTËS DHE TË LIRISË;
- KOMUNË QË NDERON SAKRIFICËN DHE GJAKUN E DERDHUR PËR LIRI;
- KOMUNË QË TRAJTON DHE MBËSHTET QYTETARËT QË KANË NEVOJA TË VEÇANTA;
- KOMUNË QË NDERON, PROMOVON E I JEP PËRKRAHJE TRADITËS, TRASHËGIMISË DHE GJITHË PASURISË SONË TË PËRBASHKËT, GJITHË ASAJ QË ËSHTË VLERË DHE IDENTITET I RAHOVECIT;
- KOMUNË KU PËRFAQËSOHET, MBROHET DHE PUNOHET PËR INTERESIN PUBLIK;
- KOMUNË KU PËRKUSHTIMI PËR TË VEPRUAR NDERSHËM DHE NË PAJTIM ME LIGJIN, PËRVEÇSE VULLNET, PËRCAKTIM I TË ZGJEDHURVE, JETËSOHET EDHE SI DETYRIM MORAL NDAJ ZGJEDHËSVE SI DHE NDAJ LIGJIT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHET MOZAIKU I VLERAVE NJERËZORE, DEMOKRATIKE, KULTURORE, TË TRASHËGIMISË E TË BESIMIT NË ZOT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN PAKICAT DHE PROMOVOHEN VLERAT E TYRE.

SYNIMET:

- BUJQËSI TË PËRKRAHUR PËR KATËR VJET;
- INVESTIME NË RRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, ZGJERIMIN E TYRE, ZGJATJEN E ORARIT TË SHËRBIMEVE, PAJISJE MJEKËSORE DHE INVENTARIZIM PËR QKMF DHE PËR GJITHË RRJETIN E SHËRBIMEVE PARËSORE SHËNDETËSORE;
- ARSIM CILËSOR DHE BIBLIOTEKA, PAJISJE BASHKËKOHORE, LABORATORË, MË SHUMË TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE MJETE KONKRETIZIMI NË SHKOLLA;
- HARTIMI I PLANEVE URBANE DHE NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT;
- KOLEKTORË DHE IMPIANT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA;
- ZHVILLIM EKONOMIK DHE PUNËSIM NËPËRMJET FUQIZIMIT DHE MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT;
- PËRQENDRIM PËR ZHVILLIMIN E PLANIFIKUAR TË AGROTURIZMIT;
- QENDËR E MADHE MAGAZINUESE PËR RUAJTJEN E RRUSHIT, PEMËVE DHE PERIMEVE

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

Një ndër prioritet në mandatin qeverisës do të vazhdojë të mbetet zhvillimi ekonomik përmes politikave lehtësuese në taksa dhe mbështetje të bizneseve të reja, atyre të vogla dhe të mesme. Duke e pasur parasysh dëmin nga kriza pandemike, një qasje e re është e nevojshme për t'ua dhënë mundësinë e ri-ngritjes bizneseve në komunën tonë.

- Funkcionalizimi i Zonës Ekonomike në Apterushë – Pas licensimit të ZE në Apterushë, do të përgatitet plani për funksionalizimin e tërësishëm. Ky investim parashikohet ta rrisë aktivitetin afarist në komunën tonë;
- Krijimi i hapësirave të reja për zhvillimin e bizneseve – Do të krijohen hapësira të reja për biznese në: Rahovec (pjesët më afër qytetit), Krushë të Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe në fshatrat më të mëdha e më të frekuentuara në komunën e Rahovecit. Gjithashtu, në zona ku ka potencial zhvillimi, do të përpqemi të krijojmë lehtësira dhe hapësira për investime nga sektori privat;
- Lehtësira në të bërit biznes - Lehtësim i taksave komunale, sipas sektorëve – Do të bëhen vlerësimet e nevojshme për të siguruar uljen e taksave për bizneset private;
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve - Përkrahje për bizneset e reja, ato të vogla dhe të mesme Me qëllim të përmirësimit të ambientit të të bërit biznes në komunë, do të ndihmohen veçanërisht sipërmarrësit e ri, të vegjël dhe të mesëm, përmes subvencionimit edhe të zejeve të veçanta dhe të aplikimit të taksave favorizuese për ta;
- Funkcionalizimi i Shtëpisë për të moshuar;
- Funkcionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të Maja e Shkodranit;
- Mbështetja e turizmit dhe agroturizmit;
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve;
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes;
- Investime në zona turistike;
- Rritje e përkushtimit dhe intensitetit të veprimeve për projekte të ndryshme dhe suksese të reja në PPP;
- Përfshirje e të rinjëve në tregun e punës, me përkrahje direkt nga komuna e cila synon krijimin e mjediseve të përshtatshme dhe përkrahje me teknologji informative, ku përmes ideve të reja e projekteve konkrete (inovative) të hapet perspektivë për ta;
- Promovimi i turizmit në komunën e Rahovecit.

2. Forcimi i sektorit të bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë.

Strategjia për zhvillimin e bujqësisë duke e harmonizuar me politikat dhe strategjinë e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen të gjithë sektorët që zhvillohen në komunën tonë me theks të veçantë: vreshtaria dhe primekultura.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen programe të veçanta që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e kushteve të punës për fermerët kultivues të pemëve dhe perimeve.

Fokusi në këtë periudhë do të orientohet në dy drejtime, si:

- Zbatimi i projekteve që prekin direkt fermerët dhe
- Zhvillimi i sektorit të agro-turizmit.

2.1 Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor, duke i klasifikuar për secilin sektor si:

- Perimekulturë dhe pemëtari - mekanizëm bujqësor (makina mbjellëse, motokultivator, spërkatëse, frezë, pllug, etj.), komora ftohëse, makineri për tharje të bimëve mjekuese aromatike, inkubator etj.
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra (sipërfaqe 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari, do të shohim mundësinë që kjo sipërfaqe të rritet në vazhdimësi)
- Përkrahja e bujqve për ngritje të fidanishteve për prodhim të fidaneve cilësore;
- Përkrahje fermerëve me farëra, pleh kimik dhe me inpute bujqësore;
- Sektori i blegtorisë - përkrahje në makina mjelëse, stalla dhe ferma të vogla, shërbime veterinare (vaksinimi, kontrolla e kafshëve, repelimi etj.);
- Marrja e mostrave të tokave bujqësore për analiza;
- Sektori i bletarisë - koshere për bletë, pajisje për trajtim dhe ruajtje të mjaltit, centrifugë etj.,
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes;
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventar;
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve;
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit;
- Hapja e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë si: funksionalizimi i tregut në Krushë të Madhe, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e 2 tregjeve të reja në qytetin e Rahovecit, po ashtu vazhdimin e fazës së tretë të projektit “Infrastruktura e tregut të rrushit” - te Shtëpia e Verës;
- Në bashkëpunim me zyrën këshillmore, që operon në kuadër të MBPZHR-së organizimin e trajnimeve për të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë;
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni;

Menaxhimi me kujdes i tokës bujqësore komunale, duke i respektuar procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme përmes ankandit publik

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre;
- Ndërtimin e rrugëve fushore, me theks të veçantë mirëmbajtja e tyre;
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore;
- Pastrimi dhe zgjerimi i përrrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë;
- Drenazhimi i tokave bujqësore;

- Rrjeti sekondar i sistemit të ujitjes në lokacione ku ekziston rrjeti primar, si dhe zgjerimi i rrjetit në pjesën kodrinore në koordinim me kompanitë publike, donatorët e jashtëm dhe Qeverinë që të kemi përparim dhe investime konkrete në këtë drejtim, në katër vitet e ardhshme qeverisëse për sigurim të ujit për ujitje, poashtu duke shfrytëzuar edhe burimet tjera alternative të ujit.

2.2 Zhvillimi i sektorit të agro-turizmit

- Investimi në ngritjen e bujtinave dhe investimi në infrastrukturë në zonat e shpallura turistike si: Hapësira të burimi-Zhdrella, Burimi në fshatin Zatriq, Pishat në fshatin Kaznik, Hapësira të Maja e Shkodranit, Vendi i quajtur Bllata, Kanioni Drini i Bardhë: ku aktivitetet e agroturizmit si pjesë të një ose më shumë kategorive janë: mikpritja (qëndrimi ose fjetja në bujtina për një ose disa netë), rekreacioni (p.sh. shtegu i ecjes, gjuetia, kalërimi), dhe argëtimi (p.sh. dreka ose darka).
- Hapja e një zyre për informim dhe krijimi i një guide për turistët rreth zonave turistike të identifikuara në komunë e Rahovecit;
- Promovimi i zonave të përshtatshme për zhvillim të turizmit përmes Hartave dhe shënjimit në tërë territorin e komunës sonë;
- Organizimi i festivaleve të ndryshme që kanë karakter promovimi të produkteve bujqësore që kultivohen në komunën tonë, si: Festa e Vjeljes së Rrushit – HardhFest, Agrofesta, panairë të ndryshme etj;
- Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Mbrojtja dhe ruajtja e sipërfaqeve pyjore do të ketë vëmendje të shtuar;
- Toka e cila është nën menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës (APK) do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim

- Ndërtimi i shkollave të reja – Do të bëhet një rivlerësim i nevojës për objekte të reja shkollore në qytetin dhe fshatrat e Rahovecit. Në bazë të këtij rivlerësimi, Komuna e Rahovecit do të investojë që të rinovohen apo ndërtohen objektet e reja të arsimit fillor dhe të mesëm;
- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim;
- Eficienca e energjisë në shkollë, sipas nevojave;
- Investime në mjete konkretizimi të laboratorike, teknologji informative, tabela dixhitale dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra;
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, këshillave drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve;
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkollë;
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimdhënësve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit edukativo arsimor në shkollë përmes Komisionit për Monitorim të themeluar nga DKA;
- Funksionalizimi i plotë i 3 çerdheve për fëmijë, të sapo ndërtuara.
- Organizimi dhe mbajtja periodike e garave të diturisë për nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar.

- Zgjerimi i Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta – Siç e dimë, DKA në katër vitet e fundit, në bashkëpunim me Ekipet Profesionale të saj ka arritur që për herë të parë të hartojë dhe të vëjë në përdorim Pakon Pedagogjike për klasat parafillore dhe klasat e programit fillor (1-5). Kjo Pako Pedagogjike do të hartohet dhe të vihet në përdorim edhe për klasat e larta (6-9), po ashtu edhe për klasat (10-12). Me zgjerimin e saj, në komunën tonë do të ketë Pako Pedagogjike unike për të gjithë mësimdhënësit e të gjitha shkollave;
- Vazhdimi i funksionimit të suksesshëm të Qendrës Arsimore për nxënësit e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Komuna jonë do të kujdeset që Qendra Arsimore për nxënësit e këtyre komuniteteve, e themeluar gjatë këtij mandati katër vjeçar, të vazhdojë funksionimin e saj normal, duke mundësuar arsimim dhe edukim shtesë për fëmijët e këtyre komuniteteve;
- Bursa për studentë dhe përkrahje gjithë atyre profesionistëve që na përfaqësojnë si komunë ose si shtet e na bëjnë krenar me dijet dhe shkathtësitë e tyre;
- Edukim për kategoritë me nevoja të veçanta – Komuna do të ofrojë transport, por edhe kushte specifike të mësimnxënies, duke iu përshtatur nevojave dhe kapaciteteve të tyre për vijimin e mësimi;
- Më shumë çerdhe – Qeverisja lokale, duke e parë nevojën për çerdhe të reja, do të investojë për hapjen e tyre në zona urbane, por edhe në vendbanime të mëdha rurale ku nuk ka çerdhe në afërsi, përmes Partneritetit Publiko- Privat, si në : Apterushë, Drenoc, Çifllak dhe Rahovec.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe kualitetit të shërbimeve të ofruara;
- Investime në maternitet - Do të përmirësojmë kushtet në maternitetin e Rahovecit, përmes angazhimit të stafit profesional dhe sigurimit të pajisjeve të reja për stafin shëndetësor;
- Ndihma momentale për pacientët me sëmundje terminale - Komuna e Rahovecit do të ndajë një fond për t'u dalë në ndihmë pacientëve me sëmundje të rënda, përmes mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve;
- Shëndeti mendor – Do të angazhojmë ekupe profesionale (psikologë, pedagogë, punëtorë social, logopedë etj.) për ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këto lloj shërbimesh, si dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për bashkëpunim sa më funksional dhe koordinim sa më të mirë me Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor në Gjakovë;
- Pediatri në QKMF dhe vizita pediatrie nëpër çerdhe – Departamenti i Pediatrisë në Komunën e Rahovecit do t'i rrisë kapacitetet dhe do të ofrojë shërbime të zgjeruara, siç është ofrimi i shërbimeve të pediatri nëpër çerdhet e komunës;
- Rriorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet;
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile;
- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak;
- Parandalimi i sëmundjeve ngjithëse dhe jo ngjithëse;
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë;
- Shtimi i personelit shëndetësor;

- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla. Rritja e shërbimeve laboratorike (shtimi i llojeve të analizave në QKMF);
- Rritja e shërbimeve specialistike në QKMF – këshillëdhënëse;
- Trajtimi i rasteve me Covid-19 dhe përkujdesja ndaj tyre në bashkëpunim me IKSHP-në dhe Klinikën Infektive;
- Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i objekteve shëndetësore, Administratës Komunale dhe hapësirave publike;
- Krijimi i hapësirave për karantinë, (sëmundjet ngjitëse), objekti i QMF-së (në rast nevojë);
- Rritja e gamës së shërbimeve laboratorike;
- Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës sonë;
- Decentralizimi i shërbimeve mjekësore (QMF,AMF);
- Barna esenciale - Komuna do të ndajë buxhet për sigurimin e barnave esenciale për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit;
- Vizitë në shtëpi për gra shtatzëna, dhe fëmijët 0-3 vjeç;
- Krijimi i këshillit të pacientëve;
- Funkcionalizimi i urgjencës njëzet e katër orë, me dy mjekë specialistë, dhe katër infermierë.

1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Pyllëzimi i hapësirave kodrinore;
- Inspektimi i shtuar për parandalimin e ndotjes dhe shkatërrimit të mjedisit dhe krijimi i deponive për mbeturina të materialeve të forta si dhe krijimi i hapësirave të gjelbra;
- Ndërtimi i parqeve të bukura dhe mirëmbajtja e tyre;
- Planet e hollësishme rregulluese në qytet – Do të bëhet hartimi i planeve të hollësishme rregulluese, të cilat do të përcaktojnë kushtet e detajuara të ndërtimit për lagjet e qytetit, formën e ndërtimit, fasadës, orientimit etj. Përmes implementimit të këtyre planeve, komuna do ta rriste mbledhjen e të hyrave, përmes lejeve të ndërtimit;
- Plane rregulluese për zonat rurale – Komuna do ta rregullojë planifikimin hapësinor të ndërtimeve edhe në fshatra, në mënyrë që të mbrohen tokat bujqësore, por edhe t'i zbatojë rekomandimet urbanistike, e që ndërtimet mos të pengojnë zhvillimin normal të jetës në këto vendbanime. Përmes planeve, ndërtimi në fshatra do të orientohet në toka të përshtatshme për ndërtim e që janë më jopjellore;
- PZHK dhe HZK - Do të miratohet Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës, pas shqyrtimit publik;
- Pjesa e vjetër e qytetit – Komuna do t'i kushtojë vëmendje të veçantë pjesës së vjetër të qytetit, përmes një plani të detajuar, duke investuar në rrugët e vjetra me kalldrëm, por edhe në objektet përreth, pa ia humbur origjinalitetin dhe duke ia kthyer pamjen që e kishte më parë;
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe përrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre;

- Konkursët e projektimit – Do të vazhdojë organizimi i shpalljes së konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit për projektet e rëndësishme kapitale në komunën tonë. Përmes konkurseve të projektimit, bëhet e mundur që arkitektët më profesionistë të bëhen pjesë e arkitekturës së përgjithshme të komunës;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim i Kompleksit Përkujtimor në Gradish;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim i Kullës për heronjtë Toni dhe Mici dhe bashkëluftëtarët e tyre në Opterushë;
- Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit (në pjesën e vjetër të qytetit);
- Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit;
- Përfundimi i Objektit për Banim Social.
- Përfundimi i plotë i shtrirjes së ndriçimit në të gjitha vendbanimet;
- Rrugët, trotualet, riasfaltimi dhe shënjimi në qytet – Do të investohet në zgjerimin dhe rregullimin e trotualet për këmbësorë, në rrugët e reja e riasfaltimin e rrugëve të dëmtuara (sidomos ato që kanë qarkullim më shumë), si dhe në ripërtëritjen e shënjimit të tyre;
- Përfundimi i rrugicave nëpër fshatra;
- Kolektorë dhe impiante për ujërat e zeza. Do të angazhohemi me donatorët të ketë investime konkrete në trajtimin e ujërave të zeza në tërë territorin e komunës së Rahovecit, përmes ndërtimit të kolektorëve dhe impianteve për trajtimin e tyre;
- Energjia e gjelbër - Energjia alternative do të praktikohet në vendosjen e objekteve publike përmes paneleve diellor, me qëllim të ekonomizimit dhe zvogëlimit të shpenzimeve;
- Digjitalizim për mbikëqyrjen e rrjetit të ndriçimit publik - përmes sistemit online dhe Platformës PHONE MOBILE, do të mundësohet verifikimi dhe mbikëqyrja e drejtpërdrejtë;
- Më shumë parkingje - Do të krijojmë hapësira të reja për parkingje veturash në disa pjesë të qytetit të Rahovecit dhe do të shenjëzohen hapësirat aktuale të parkingjeve;
- Mirëmbajtja e përgjithshme – mirëmbajtjes do t'i kushtohet rëndësi e veçantë në mandatin e ri, si një zgjidhje efikase për kursimin e parasë publike. Me mirëmbajtje, duke filluar nga rrugët, trotualet, parqet, varrezat, ndërtesat, drunjtë, ndriçimi publik dhe të gjitha asetet e infrastrukturës dhe pasurive publike, do të shpenzohet më pak, sepse do të investohet në jetëgjatësinë e tyre;
- Lidhja ndërmjet vendbanimeve me rrugë të asfaltuara – asfaltimi i rrugëve që e lidhin qytetin me zonat rurale, është projekt i përfunduar, mirëpo ka nevoja të mëdha që lidhjet ndërmjet vetë zonave rurale të jenë më të lehta. Për këtë arsye, Komuna e Rahovecit do të investojë në rrugë lokale që lidhin fshatra apo lagje të ndryshme, ku është e nevojshme. Përmes këtij investimi, lirohen nga ngarkesa edhe rrugët kryesore që shpijnë në qytet ose vendbanime të mëdha;
- Mirëmbajtje e gropave ekzistuese septike, dhe ndërtimi i gropave të reja septike;
- Në bashkëpunim me KEDS, furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj;
- Bashkëpunim me KRU GJAKOVA dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Ndërtimi i shtigjeve për biçiklistë në zonën urbane dhe periferike;
- Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;

- Trajtimi i ujërave të zeza dhe rrugëve në pjesë problematike të Qytetit;
- Plani i mobilitetit;
- Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre;

2. Administratë e Përgjithshme

- Komunë e hapur për qytetarët - transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejtë dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë ku ju shërbehet qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Transparencë për qytetarë – Komuna e Rahovecit do të përkushtohet në rritjen e transparencës përmes aplikimit të metodave të reja të komunikimit online për qytetarë dhe medie;
- Shërbimet komunale janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj Komuna e Rahovecit do të investojë në vazhdimësi në modernizimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile;
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile;
- Sistemimi i zyrtarëve të zyrës së pranimit, kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, që kanë për qëllim shkurtimin e kohës për palët;
- Funksionalizimi i sporteleve të veçanta për mërgatën;
- Më shumë pajisje digjitale (E-KIOSK) për ofrimin e sa më shumë shërbimeve për qytetarët;
- Funksionalizimi i ONE STOP SHOP (kryerja e shërbimeve me ndalim në një vend).

3. Rinia, kultura dhe sporti

- Përkahje e të rinjve shoqatave kulturo-artistike dhe klubeve sportive;
- Subvencionimi i projekteve - Do të vazhdojë subvencionimi i projekteve kulturo-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Përfundimi i Qendrës për Arte, Kulturë dhe Inovacion – Komuna e Rahovecit do ta përfundojë Qendrën për Arte, Kulturë dhe Inovacion, e cila do të jetë një hapësirë që do të përmbushë nevojat e komunitetit artistik dhe të të rinjve në fushën e artit, kulturës dhe inovacionit;
- Fusha sportive në çdo fshat dhe lagje;
- Trashëgimia kulturore dhe historike – Komuna do të vazhdojë të kujdeset për objektet e trashëgimisë kulturore, duke mirëmbajtur infrastrukturën e tyre dhe përreth tyre, por edhe do të krijojë atraksione turistike nga to;
- Përfshirja e objekteve të rëndësishme të veçantë në listën e monumenteve që janë nën përkujdesje institucionale;
- Muzetë, komplekset përkujtimore, bustet dhe shtatoret – Me qëllim të ruajtjes të së kaluarës historike, do të ketë përkujdesje të veçantë, si dhe do të themelohen muze dhe komplekse të reja përkujtimore, në bashkëpunim me komunitetin dhe historianët lokalë. Po ashtu, do të mirëmbahen shtatoret dhe bustet ekzistuese të dëshmorëve, por në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta do të realizohen edhe shtatore dhe buste të rinj, për t'i nderuar të rënët për liri;

- Rritje e përkrahjes për festivalet tradicionale dhe ngjarjeve të tjera të shënuara për afirmimin e vlerave kulturore, të trashëgimisë historike dhe të turizmit;
- Themelimi i Ansambllit Profesional të Këngëve dhe Valleve të Rahovecit;
- Qendra inovative funksionale për të rinjtë;
- Kompleksi sportiv tek EPOPEJA E UÇK-së mbi Rahovec;
- Stadiumi i Qytetit të Rahovecit;
- Mbështetje rinisë për ide kreative dhe artistike;
- Mbështetja e të gjitha klubeve dhe shkollave sportive etj.
- Trajtimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sporteve, fushave sportive dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive dhe objekteve kulturore;
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë;
- Intervenimi dhe restaurimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre;
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë;
- Krijimi i hapësirave për biblioteka në vendbanimet e komunës së Rahovecit (aty ku ka hapësira).
- Formimi i ansambllit të këngëve dhe valleve të komunës së Rahovecit;
- Hartimi i strategjisë për rini;

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Indikatorët ekonomik komunal

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2023-2025 ku parashihet një rritje reale vjetore, **4.10 %** në vitin 2023, ndërsa rritja reale e Bruto produktit të vendit në 2023 - 2025 parashihet të jetë **4.20 %**, respektivisht **3.90 %**.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme ulet me **1.45 %**, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshin: 1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grandet qeveritare. Komunitat po ashtu janë pranues të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2023-2025, nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, eventualisht ndonjë projekt tjetër me rëndësi strategjike për komunën tonë, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Përshkrimi	2022	2023	2024 (vlerësimet)	2025 (vlerësimet)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	5.0	4.1	4.2	3.90
Inflacioni në %	1.90	2.80	1.80	1.20
BPV për kokë banori, në euro	7.243	9.621	10.408	11.156
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2.475	2.602	2.640	2.690
Numri i nxënësve	9.422	9,012	9,000	8,822

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2023-2025

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2023-2025

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grandet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Paraqitja grafike 1: Buxheti Total i Komunës në vitet (2023 – 2025), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2022 grandet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej **5,89 %** në vitin 2022. Rritja e Grandit Qeveritar do të jetë **17.51 %** në vitin 2023 në krahasim me 2022, ndërsa të hyrat vetanake në vitin 2023 do të kenë një rritje prej: **7.04%** në krahasim me 2022.

Nga viti 2023-2025 parashihet një rritje prej **7.83 %** në tërësi, sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 2 më poshtë, në Grandin qeveritar parashihet të ketë rritje prej **7.83 %** ndërsa në të hyrat vetanake **4,73 %** kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nacionale, siç parashihet me qarkoren 2023/01 (KASH 2023-2025).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2023-2025, në Euro

Burimi i të hyrave	2022	2023	2024	2025
Plani	1,350,548.00	1,445,603.00	1,505,186.00	1,569,652.00
Buxhet dhe Financa	792.117.00	880,514.00	907,342.00	937,417.00
Tatimi në Pronë	532.117.00	423,250.00	431,715.00	442,508.00
Tatimi në Tokë	170.000.00	367,264.00	385,627.00	404,909.00
Taksat rrugore	90,000.00	90.000.00	90,000.00	90,000.00

Administrata dhe Personeli	119,700.00	118,589.00	122,200.00	121,000.00
Taksa Çertifikatat e lindjes	14,000.00	14,000.00	14,000.00	15,000.00
Taksa Çertifikatat e kurorëzimit	9,000.00	8,000.00	9,000.00	9,000.00
Taksa Çertifikatat e vdekjes	1,500.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Taksa Çertifikatat tjera ofiqarie	44,000.00	45,389.00	47,000.00	45,000.00
Takse për pjesëmarrje ne tender	200.00	200.00	200.00	0.00
Taksë për verifikimin e dokumenteve	1,000.00	5,000.00	6,000.00	6,000.00
Taksa tjera administrative	50,000.00	44,000.00	44,000.00	44,735.00
Inspekcioni	2,400.00	6,500.00	6,500.00	11,500.00
Gjobat nga inspektoriati	1,000.00	5,000.00	5,000.00	10,000.00
Licencë për pranimin e lokalit	900.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Inspektimi higjienik dhe sanitar	500.00	500.00	500.00	500.00
Shërbime Publike	12,150.00	10,800.00	12,700.00	14,000.00
Taksa për leje gërmime	400.00	1,000.00	1,500.00	2,000.00
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	0.00	0.00		
Shfrytëzimi i pronës publike	4,500.00	3,000.00	2,000.00	2,500.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	4,700.00	3,000.00	5,000.00	5,000.00
Qiraja nga objektet publike	2,000.00	3,000.00	3,200.00	3,500.00
Licenca të lira individuale	250.00	300.00	500.00	600.00
Largimi dhe deponimi i automjeteve	300.00	500.00	500.00	400.00
Bujqësia dhe zhvillimi rural	72,000.00	44,000.00	51,000.00	56,838.00
Taksa -të hyrat nga pyjet	0.00	0.00	0.00	0.00
Shfrytëzimi i pronës publike(Qiraja e tokës bujqësore)	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,500.00
Participimet në bujqësi	70,000.00	42,000.00	49,000.00	55,355.00
Taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,000.00	1,000.00	1,000.00	0.00
Ekonomia dhe Zhvillimi	145,450.00	157,000.00	159,000.00	175,000.00
Licenca të lira individuale	0.00	0.00	0.00	0.00
Licenca për shërbime profesionale	150.00	0.00	0.00	0.00
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë	65,000.00	75,000.00	76,000.00	80,000.00
Qiraja nga vendosja e objektit tregtar	80,300.00	82,000.00	83,000.00	95,000.00
Kadastër dhe Gjeodezia	42,000.00	55,000.00	63,000.00	65,000.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	24,000.00	30,000.00	33,000.00	35,000.00
Taksa për matjen e tokës në terren	18,000.00	25,000.00	30,000.00	30,000.00
Urbanizmi	91,531.00	68,000.00	77,000.00	76,200.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	44,000.00	36,000.00	41,000.00	36,000.00
Taksa për demolim	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Taksa për legalizimin e objekteve	38,531.00	21,000.00	23,000.00	25,000.00
Inspektimi respektimi i planit urbanistik	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,200.00
Leje mjedisore komunale	6,000.00	8,000.00	10,000.00	12,000.00

Shëndetësia dhe mirëqenienë sociale	61,000.00	61,000.00	62,000.00	62,500.00
Participimi nga shëndetësia	61,000.00	80,000.00	80,000.00	80,000.00
Kulturë, Rini, Sport	1,000.00	3,000.00	4,244.00	7,500.00
Shitja e shërbimeve(Biblioteka)	1,000.00	3,000.00	4,244.00	7,500.00
Arsimi dhe Shkencë	11,200.00	22,200.00	22,200.00	25,200.00
Participimet -çerdhja e femijëve	11,000.00	22,000.00	22,000.00	25,000.00
Participimi në arsim	200.00	200.00	200.00	200.00

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorët e jashtëm gjatë vitit 2023-2025, presim qe te kemi donacione.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar Qeveria Nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të iniciuara në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2023-2025, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grandit të Përgjithshëm të Komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë Qendrore, (duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 9%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2023 dhe 2025 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende në këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe duke menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grandit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grandit të arsimit për komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grandin e arsimit, sidomos duhet pasqyruar se ky grand përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk i ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, komuna e Rahovecit ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Grandi i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish Qeveria Nacionale ka shtyrë drejtë politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes, eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesave komunale që rëndojnë ambientin biznesor

komunal. Edhe në të ardhmen barra kryesore në realizimin e hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin në tokë.

3.3 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2023-2025

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2023/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2023, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëditje.:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 do të paraqesim sipas kategorive ekonomike:

• Pagat dhe Mëditjet	8.453.088.00
• Mallrat dhe Shërbimet	2.133.829.00
• Shpenzimet Komunale	370.000.00
• Subvencionet dhe Transferet	820.000.00
• Shpenzimet Kapitale	5.771.323.00
TOTAL	17.548.240.00

3.3.1 Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **13.61 %** si rezultat i , pagesën e stazhit të punës . Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **52.29 %**.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është rritur për **47.23 %** nga viti 2022 në vitin 3 Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2023 pritet të jetë mesatarisht **14.27 %**.

3.3.3 Subvencionet

Në vitin 2023 komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, Ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport. Gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **163.67 %**. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2023 mesatarisht do të jetë **4.67 %**.

3.3.4 Investimet Kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2023, për **30.00 %** krahasuar me vitin 2022. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2023 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: **31.99 %**.




Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2022-2025, në euro.

	Përshkrimi	2022	2023	2024	2025
			(plan)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	15,053,660.00	17,548,234.00	18,868,048.00	19,646,625.00
	Të hyrat vetanake	1,350,548.00	1,445,603.00	1,505,186.00	1,569,652.00
	Grandet dhe transferet qeveritare	13,703,112.00	16,102,634.00	17,362,862.00	18,076,973.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	15,053,660.00	17,548,237.00	18,868,048.00	19,646,625.00
	Shpenzimet mjedhëse	10,287,844.00	12,776,912.00	13,022,863.00	12,673,945.00
	Pagat dhe mëditjet	7,872,844.00	8,453,088.00	8,595,913.00	8,638,893.00
	Mallrat dhe shërbimet	1,735,000.00	2,133,829.00	2,232,052.00	2,237,052.00
	Shpenzimet komunale	270,000.00	370,000.00	375,000.00	380,000.00
	Subvencionet	360,000.00	820,000.00	820,000.00	820,000.00
3	Shpenzimet Kapitale	4,805,806.00	5,771,325.00	5,845,083.00	7,570,680.00

	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktualet të vitit 2022, planifikimi për vitin 2023-2025 si dhe projeksionet përgatitjes në (Tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2022, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	174.457	55.000		129.000		358.457
Administrata	216.182	176.000			20.000	412.182
Çështjet Gjinore	5.281	2.000				7.281
Inspektimet	71.097	15.000			20.000	106.097
Zyra e Kuvendit Komunal	106.593	20.000				126.593
Buxhet dhe Financa	99.337	130.000			60.000	289.337
Shërbime publike	27.504	255.981	156.000		1.206.006	1.645.491
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	148.586	15.000			30.000	193.586
Zyra Lokale për Komunitete	58.549	16.850			20.000	95.399
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	64.836	60.000		40.000	1.400.000	1.564.836
Zhvillimi Ekonomik	43.709	15.800		20.000	120.000	199.509
Kadastria dhe Gjeodezia	64.047	17.000			30.000	111.047
Planifikimi Urban dhe Mjedis	40.551	30.000			900.000	970.551
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1.076.450	430.000	50.000	71.000	394.598	2.022.048
Qendra për punë Sociale	100.780	10.000	4.000			114.780
Kulturë, Rini, Sport	67.034	45.000		100.000	250.000	462.034
Administrata e Arsimit	53.550	55.000			300.000	408.550
Arsimi Parafillor	47.850	36.369	3.000			87.219
Arsimi Fillor	4.231.892	240.000	44.000		65.212	4.581.104
Arsimi I mesëm	1.174.559	110.000	13.000			1.297.559
TOTAL	7.872.844	1.735.000	270.000	360.000	4.815.816	15.053.660

Tabela 5: Shpenzimet për 2023, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	178.520,00	55.000,00		160.000,00	-	393.520,00
Administrata	217.362,00	175.830,00			20.000,00	413.192,00
Çështjet Gjimore	5.308,00	2.000,00			-	7.308,00
Inspektimet	71.454,00	15.000,00			-	86.454,00
Zyra e Kuvendit Komunal	107.126,00	17.000,00			-	124.126,00
Buxhet dhe Financa	100.202,00	250.000,00			70.000,00	420.202,00
Shërbime publike	27.650,00	425.000,00	226.000,00		1.673.998,00	2.352.648,00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	149.328,00	15.000,00			-	164.328,00
Zyra Lokale për Komunitete	58.850,00	15.000,00			20.000,00	93.850,00
Bujqësia, Pëlltaria dhe Zhvillim	65.162,00	60.000,00		440.000,00	1.523.114,00	2.088.276,00
Zhvillimi Ekonomik	43.928,00	17.000,00		20.000,00	279.000,00	359.928,00
Kadastra dhe Gjeodezia	64.368,00	16.000,00			-	80.368,00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	40.754,00	180.000,00			847.880,00	1.068.634,00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1.730.930,00	414.510,00	70.000,00	90.000,00	374.598,00	2.680.038,00
Qendra për punë Sociale	101.284,00	10.000,00	4.000,00		-	115.284,00
Kulturë, Rini, Sport	67.370,00	50.000,00		100.000,00	710.054,00	927.424,00
Administrata e Arsimit	53.820,00	55.000,00			159.395,00	268.215,00
Arsimi Parafillor	49.243,00	25.469,00	4.000,00			78.712,00
Arsimi Fillor	4.140.187,00	234.120,00	50.000,00		63.084,00	4.487.391,00
Arsimi I mesem	1.180.242,00	101.900,00	16.000,00		30.200,00	1.328.342,00
TOTAL	8.453.088,00	2.133.829,00	370.000,00	810.000,00	5.771.323,00	17.538.240,00

Tabela 6: Shpenzimet , projeksionet 2024, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Zyra e Kryetarit	180.412,00	55.000,00		160.000,00	-	395.412,00
Administrata	220.448,00	175.830,00			45.279,00	441.557,00
Çështjet Gjimore	5.336,00	2.000,00			-	7.336,00
Inspektimet	72.110,00	15.000,00			-	87.110,00
Zyra e Kuvendit Komunal	108.210,00	17.000,00			-	125.210,00
Buxhet dhe Financa	109.518,00	250.000,00			70.000,00	429.518,00
Shërbime publike	27.820,00	425.000,00	226.000,00		2.087.825,00	2.766.645,00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	151.074,00	15.000,00			-	166.074,00
Zyra Lokale për Komunitete	59.150,00	15.000,00			30.000,00	104.150,00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	65.520,00	60.000,00		440.000,00	1.769.418,00	2.334.938,00
Zhvillimi Ekonomik	44.210,00	17.000,00		20.000,00	224.049,00	305.259,00
Kadastra dhe Gjeodezia	64.710,00	16.000,00			-	80.710,00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	40.980,00	180.000,00			1.264.638,00	1.485.618,00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1.730.930,00	425.000,00	75.000,00	90.000,00	489.110,00	2.810.040,00
Qendra për punë Sociale	102.120,00	10.000,00	4.000,00		-	116.120,00
Kulturë, Rini, Sport	67.800,00	50.000,00		110.000,00	500.000,00	727.800,00
Administrata e Arsimit	54.090,00	55.000,00			60.000,00	169.090,00
Arsimi Parafillor	50.754,00	59.369,00	4.000,00		-	114.123,00
Arsimi Fillor	4.251.660,00	259.853,00	50.000,00		63.084,00	4.624.597,00
Arsimi I mesem	1.189.061,00	130.000,00	16.000,00	241.680,00		1.576.741,00
TOTAL	8.595.913,00	2.232.052,00	375.000,00	1.061.680,00	6.603.403,00	18.868.048,00

Tabela 7: Shpenzimet, projeksionet 2025, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nen programe :

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	181.314,00	55.000,00		160.000,00	0,00	396.314,00
Administrata	221.550,00	172.830,00			20.000,00	414.380,00
Çështjet Gjinore	5.363,00	2.000,00			0,00	7.363,00
Inspektimet	72.471,00	15.000,00			0,00	87.471,00
Zyra e Kuvendit Komunal	108.751,00	17.000,00			0,00	125.751,00
Buxhet dhe Financa	110.065,00	250.000,00			70.000,00	430.065,00
Shërbime publike	27.959,00	425.000,00	226.000,00		2.530.000,00	3.208.959,00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	151.829,00	15.000,00			0,00	166.829,00
Zyra Lokale për Komunitete	59.446,00	15.000,00			30.000,00	104.446,00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	65.848,00	60.000,00		440.000,00	2.042.531,00	2.608.379,00
Zhvillimi Ekonomik	44.431,00	17.000,00		20.000,00	73.227,00	154.658,00
Kadastra dhe Gjeodezia	65.034,00	16.000,00			0,00	81.034,00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	41.184,00	180.000,00		0,00	1.395.298,00	1.616.482,00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1.739.585,00	430.000,00	80.000,00	90.000,00	606.957,00	2.946.542,00
Qendra për punë Sociale	102.630,00	10.000,00	4.000,00		0,00	116.630,00
Kulturë, Rini, Sport	68.139,00	50.000,00		110.000,00	440.000,00	668.139,00
Administrata e Arsimit	54.360,00	55.000,00			60.000,00	169.360,00
Arsimi Parafillor	51.008,00	62.369,00	4.000,00			117.377,00
Arsimi Fillor	4.272.918,00	259.853,00	50.000,00		302.667,00	4.885.438,00
Arsimi I mesem	1.195.006,00	130.000,00	16.000,00			1.341.006,00
TOTAL	8.638.891,00	2.237.052,00	380.000,00	820.000,00	7.570.680,00	19.646.623,00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më lartë, paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së

sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të punësuar në kuadër të komunës, dhe i paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Sqarim: Tabela e më poshtme bazohet në shifrat sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve, të qershorit 2021 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela 8: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Tabela 1.

Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore

Emri i institucionit

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit - gra	Numri i stafit - burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2020	1186	437	749	2,607,464.28	4,399,946.88
2021	1186	476	710	1.413.872.58	2.146.315.82
Planifikimi 2022	1184	441	743		

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2023 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Emri i institucionit

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	255	185	811,423.44	70	394,595.16

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve - i grave	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2020	320,532.48	635	251	384	112,186.37	208,186.00
2021	311,000.00	1156	478	678	144325.94	332874.06
Planifikimi 2022	360,000.00					

Komuna do t'i përdor më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor në paga dhe mëditje në buxhetet e vitit 2022 për të përgatitur buxhetin në të ardhmen duke respektuar buxhetin e përgjithshëm gjinor. Tek investimet kapitale, kur një projekt është për një qytet të caktuar apo të një fshati, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj. ne do të përdorim të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne do të përdorim numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

Drejtori për Buxhet dhe Financa



Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arkiva - Archive

Nr. Dokumenti: 01/400
Nr. Protokol: 996/2022
Data: 13.05.2022
Nr. i llogaritjes: 70
Në: pages: 1
Drejtuesi: PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere /
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Zyra e Ministrat / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATE/A:	13.05.2022
PËR/ZAT/O:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar.
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2023/01

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2023.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2023/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror dhe kufijtë buxhetor të nivelit komunal për vitin 2023-2025. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit të ndarjeve buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2023/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negociim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2023

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2023, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit deri në fund vit të buxhetit të vitit 2022 në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Po ashtu, organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për nën apo mbi shpenzimet eventuale në buxhetin aktual, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2023, dhe vlerësimeve për 2024-2025.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2023-2025

Procesi buxhetor për vitet 2023-2025 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2023-2025. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm në bazë të hapësirës së lirë fiskale dhe nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2023-2025. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat buxhetore brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2023-2025 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale, duke përfshirë obligimet e shpronësimit lidhur me ato projekte;
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues dhe
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioritetëve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe duhet të fokusohen në këto fusha: drejtësi dhe ligj; ekonomi dhe punësim; arsim; shëndetësi; siguri; integritet euro-atlantik; dhe mjedis.

Shpenzimet rrjedhëse: organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

Pagat dhe shtesat: Organizatat buxhetore duhet të planifikojnë rritjen vjetore të faturës së pagës në nivel prej 0.5% sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063.

Mallra dhe shërbime: Organizatave buxhetore do të mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2022.

Subvencionet dhe transferet: Subvencionet dhe transferet, planifikohet të kenë ulje mesatare prej 3.6% përgjatë periudhës 2023-2025. Shpenzimet në këtë kategori pritet të jenë 9.1% në raport me BPV-së gjatë periudhës afatmesme. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në hujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.06.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510069-00759-0 në Zonën Kadastrale Retijë

1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510069-00759-0** në Zonën Kadastrale Retijë, në sipërfaqe prej 500m² (pesëqind metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2058m² (dymijë e pesëdhjetë e tetë metra katror) në vendin e quajtur Padine - do drvishki, me kulturë kullosë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Ilija (Cvetka) Nikoliq.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Meremetimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve".
3. Parcela e cekura në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet në zënë bujqësore klasa e bonitetit III.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC


01-Nr. ____/22
Datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Kabineti i Kryetarit të Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008”), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510069-00759-0 në Zonën Kadastrale Retijë

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510069-00759-0** në Zonën Kadastrale Retijë, në sipërfaqe prej 500m² (pesëqind metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2058m² (dymijë e pesëdhjetë e tetë metra katror) në vendin e quajtur Padine - do drvishki, me kulturë kulllosë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Ilija (Cvetka) Nikoliq.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë “Meremetimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve”.
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- Kuvendi i Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Transportit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostonnog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510069-00759-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0027441/22
Data dhe koha e kështimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 08.06.2022 - 10:54
Komuna / Opština / Municipality: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Retinë / Retinje / Retinje
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510069-00759-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land		2058			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qanjar Mesto zvanje Called place Adresa / Address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PADINJE DOBRI VASHKI				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Superfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësori Poljoprivreda/Agriculture	Kullësi Pašnjak/pasture	Kullësi 4 Klasë 4 Pasnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	2058

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Indivudualna Drazavina / Single possessor	NIKOLIQ ILIJA (CVETKA)	KCID1506457	RETI / RETI / RETI /		RETI 33	1/1		





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Retijë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510069-00759-0	Parcelë / Parcela / Parcel	2058



Shkalla/Razmera/Scale: 1:833



Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 11:01:10

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu


Department of Cadastre



Skica e terrenit

Z.K. Retijë

P/1:500



Rahovec me 08.06. 2022



Miftar Krasniqi geom.



2.k. Petijé
759-0



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Data:	09.06.2022
Për:	Znj. Ardita latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave, MAPL
CC:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Përmes	Albnor Mullabazi Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit - Komuna e Rahovecit
Lënda / subjekti	Letër Konfirmuese
Baza:	Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative

Të nderuar:

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit me anë të kësaj letre, ju konfirmojmë se: Prona e cila është subjekt i shpalljes së interesit të përgjithshëm është pjesë e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2013-2023 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 dha ka destinim të përhershëm.

Ngastrat kadastrale me Nr. P-71510052-00369-0, Vendi i quajtur Padina-Do Drvishki, me sipërfaqe 2058 m², pronar Nikoliq Ilija (Cvetka) z.k. Retijë. Në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë gjindet në Zonë Bujqësore Klasa e Bonitetit III.

Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

Pëlqimi ti dërgohet :

- 1. Palës***
- 2. Arkivit të Drejtorisë.***



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.06.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510052-00369-0 në Zonën Kadastrale Mrasor

1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510052-00369-0** në Zonën Kadastrale Mrasor, në sipërfaqe prej 240m² (dyqind e dyzet metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10610m² (dhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë metra katror) në vendin e quajtur Ornica – Livada vila, me kulturë arë e klasës 7, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Sokol (Rexh) Rexhepi nga fshati Mrasor, Komuna e Rahovecit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Meremetimi i shtabit të UÇK-së në zonën e Mrasorit".
3. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine/Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2254 Nr. i faq./Br.st./No.pg 389
Data/Datum/Date 9.6.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510052-00369-0 në Zonën Kadastrale Mrasor

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510052-00369-0 në Zonën Kadastrale Mrasor, në sipërfaqe prej 240m² (dyqind e dyzet metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10610m² (dhjetëmijë e gjashtëqind e dhjetë metra katror) në vendin e quajtur Ornica – Livada vila, me kulturë arë e klasës 7, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Sokol (Rexh) Rexhepi nga fshati Mrasor, Komuna e Rahovecit.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë "Meremetimi i shtabit të UÇK-së në zonën e Mrasorit".
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- Kuvendi i Komunës,
- Sekretaria e Kuvendit,
- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Življne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510052-00369-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0027442/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	08.06.2022 - 10:55
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Mirasor / Mirasor / Mirasor
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA						
Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Supërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On
P-71510052-00369-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land		10610		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitet Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
ORNICA-LIVADA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Supërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësori Poljoprivredno Agriculture	Arit/Njive Arable	Arit E Klasës 7/Njiva 7 Klasa/7th Class Arable Land	10610

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prehivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poselemi individual / Individualna Drzavina / Single possessor	REXHEPİ SOKOL (REXH)	KCID1505470	MIRASOR / MIRASOR / MIRASOR /		MIRASOR	1/1		





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Mrasor

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510052-00369-0	Parcelë / Parcela / Parcel	10610



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1599

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.06.2022

Koha/ Vreme/ Time: 01:42:21


Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Approvoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

365-0
2.k
Mrasor





KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC
SKUPSTINA OPSTINE RAHOVEC
MUNICIPALITY ASSEMBLY RAHOVEC
DREKTORIA PER KADASTER, GJEODEZI DHE PRONE
ODELJENJE ZA KATASTAR, GEODEZIJU I IMOVINU



Skica e terenit

Z.K. Mrasor

P/1:1000

Parc. nr. 369-0

Rrugë e Fshatit nr. 505-0
pjesa e parc.
nr. 369-0 në
sipërfaqe:
2 40m²

Rahovec me 08.06.2022



Miftar Krasniqi gjeom.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit
Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Data:	09.06.2022
Për:	Znj. Ardita latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave, MAPL
CC:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Përmes	Albnor Mullabazi Drejtori i Drejtorisë për Urbanizam, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit
Lënda / subjekti	Letër Konfirmuese
Baza:	Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative



Të nderuar:

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit me anë të kësaj letre, ju konfirmojmë se: Prona e cila është subjekt i shpalljes së interesit të përgjithshëm është pjesë e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2013-2023 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 dhe ka destinim të përhershëm.

Ngastrat kadastrale me Nr. P-71510052-00369-0, Vendi i quajtur Ornica-Livada Vila, me sipërfaqe 10610 m², pronar Rexhepi Sokol (Rexh) z.k. Mrasor. Në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë gjendet brenda Zonës Ndërtimore.

Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

Pëlqimi ti dërgohet :

- 1. Palës***
- 2. Arkivit të Drejtorisë.***



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/22 i datës 00.00.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01038-2, P-71510033-01055-2, P-71510033-01034-0, P-71510033-01045-0, P-71510033-01033-2, P-71510033-01044-0, P-71510033-01040-0 dhe P-71510033-01036-2.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga AAK;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga LVV;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga LDK;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga PDK;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/22
Datë: 29.06.2022

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



Nr. I prot. 2201 Më 21.06 2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

INFORMATË

Janar-Qershor



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	3
Aktivitetet kryesore.....	3
Aktivitetet tjera	4
Pagesat Direkte – Subvencionet	4
PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE	7
Mekanizëm Bujqësor	8
Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Rrugëve Fushore	9
Ndërtimi i Kanaleve të Kullimit të Tokave Bujqësore	9
PËRFUNDIM.....	10

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2022, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

Aktivitetet kryesore

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 21 janar deri më 11 shkurt 2022. Në këtë periudhë gjithsej kanë aplikuar 81 fermer me sasi totale të qumështit të dorëzuar 1,9 milion litra.



- Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-së lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2021. Shumë fermer kanë pasur probleme me llogari bankare ku është kërkuar nga ne që të i ndryshojmë në menyrë që të realizojnë pagesat e tyre.
- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Duke u bazuar në kërkesat e fermerëve për marrje të tokave bujqësore me qera për qëllime bujqësore, kërkesat e fermerëve janë proceduar në Kuvend të Komunës për të marrë aprovim që këto parcela të jepen në shfrytëzim e që më pastaj të shpallim Ankandë Publik duke respektuar të gjitha procedurat sipas ligjit për dhënie të tokave bujqësore komunale me qera.
- Pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe

- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Aktivitetet tjera

Gjatë muajit Shkurt kemi shqyrtuar Planin Zhvillimor Komunal 2022 - 2029, ku në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kemi plotësuar komentet shtesë të cilat kanë qenë të nevojshme nga ana statistikore në të gjithë sektorët.

Gjithashtu së bashku me zyrtarët e DBPZHR kemi shqyrtuar Planin e Vlerësimit të Rrezikut për komunën e Rahovecit ku kemi plotësuar parametrat e caktuara në kuadër të drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe përgatitjen e skenarëve të mundshëm si fatkeqësitë nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore nga breshëri, vërshimet e faktor të tjerë.

Gjatë muajit Shkurt kemi zhvilluar takime të ndryshme të organizuar nga MBPZHR –së në lidhje me Pagesat Direkte – Subvencionet, takime për skemën e granteve, takime me Entin e Vreshtarise.

Në Mars kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e IFC –së anëtare e grupit të Bankës Botërore, ku pjesë e këtij takimi ishte diskutimi dhe informimi për sigurimet bujqësore për produktet e perimekulturës, vreshtarisë, pemëtarisë. Takimi është mbajtur në sallën e kuvendit ku pjesëmarrës ishin dhjetra fermer të interesuar për të siguruar produktet bujqësore.



Fotografi të bujqëve në sesionin informues nga përfaqësuesit e IFC-së dhe Ministrisë së BPZHR-së rreth sigurimeve bujqësore

Në këtë takim komuna e Rahovecit, mori përsipër të mbulojë 15% të primit të sigurimit të produkteve bujqësore.

Pagesat Direkte – Subvencionet

Pas hapjes së thirrjes për aplikim nga ana e MBPZHR-së, jemi mobilizuar me kapacitete të plota, si me staf poashtu edhe me mjete logjistike duke e ditur se komuna jonë ka numrin më të madh në nivel vendi (rreth 3,000).

Prandaj jemi angazhuar ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në dy qendra, Krushë e Madhe dhe Ratkoc.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2022 është **2,978**, ku krahasuar me vitin 2021 kemi 71 aplikacione më shumë.


Pas përfundimit të procesit të aplikimit, zyrtarët e angazhuar e kanë bërë kontrollimin e secilës dosje dhe të njëjtat janë dorëzuar në AZHB (Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë).

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna mëpastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

Në tabelat dhe grafikonet më poshtë janë paraqitur të dhënat sipas sektorëve të shprehura në sipërfaqe (ha) si dhe në vlera monetare (€) që nënkupton se komuna e Rahovecit do të përfitoj mbi 5,4 milion euro në vitin 2022.


Tabela 1. Të dhënat e sektorëve të shprehura në sipërfaqe sipas viteve

VITET			2020	2021	2022	Diferenca
Sektorët	Lloji	Nj. Matëse				
Sektori i Lavertarise	Dritherat	ha	3,586.00	2,019.81	3,711.24	1,691.43
	Grurë - KG	kg	0.00	3,585,232.00	0.00	N/A
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	ha	2,406.61	2,342.53	2,322.21	-20.32
	Verë	Litër	5,577,789.96	8,689,227.29	7,274,876.45	-1,414,350.84
	Fidane të hardhisë	copë	148,000.00	248,000.00	149,900.00	-98,100.00
Sektori i Perimkulturës	Perime	ha	1,438.64	1,113.94	1,213.94	100.00
	Kungullore	ha	600.50	457.85	579.58	121.73
Sektori i Pemtariisë			95.92	130.28	165.23	34.95
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	koshere	6,802.00	5,577.00	4,245.00	-1,332.00
	Lopë	krerë	2,598.00	2,335.00	1,938.00	-397.00
	Dhi	krerë	834.00	864.00	248.00	-616.00
	Dele	krerë	8,886.00	8,142.00	7,226.00	-916.00
	Pula vojëse	copë	74,300.00	43,360.00	59,100.00	15,740.00
Bimë Mjekësore dhe Aromatike	BMA	ha	14.84	14.52	16.51	1.99
Perime ne Serra	Perime te ndryshme	ha	16.50	18.70	24.26	5.56



Grafiku 1. Përfitimi i fermerëve të komunës për vitet 2020, 2021 dhe 2022

Nga të dhënat e kësaj table mund të vërejmë një rritje të sipërfaqeve në sektorin e lavërtarisë ku krahasuar me vitin 2021 kemi rreth 1600 ha më shumë sipërfaqe të mbjellura (viti 2021: 2,019.81 ha kurse viti 2022: 3711.24 ha), ku konkretisht ndryshimi më i madh është te kultura e grurit (viti 2021: 1,041 ha kurse në vitin 2022: 2,006.11 ha).



Rritje në deklarim kemi edhe te pulat vojse, ku krahasuar me vitin e kaluar këtë vit kemi për 15,740 më shumë.

Për dallim nga sektori i lavërtarisë që kishte ndryshim pozitiv me vitin e kaluar, sektori i blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë ka pësuar rënie në numër si psh: këtë vit kemi për 1,362 më pak koshere të bletëve. Poashtu rënie vërehet edhe te lopët qumështore, delet dhe dhitë.




Tabela 2. Të dhënat e shprehura në vlera monetare (€)

VITET		2020	2021	2022	Diferenca
Sektorët		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
Sektori i Lavërtarisë	Drithërat	537,900.00 €	224,847.00 €	1,255,391.96 €	1,030,544.96 €
	Grurë - KG	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,406,610.00 €	1,952,118.00 €	2,447,609.34 €	495,491.34 €
	Verë	223,111.60 €	347,569.09 €	290,995.06 €	-56,574.03 €
	Fidane të hardhisë	14,800.00 €	24,800.00 €	22,485.00 €	-2,315.00 €
Sektori i Perimkulturës	Perime	431,592.00 €	445,576.00 €	689,203.76 €	243,627.76 €
	Kungullore	180,150.00 €	183,140.00 €	210,956.32 €	27,816.32 €
Sektori i Pemtarisë		38,368.00 €	52,112.00 €	74,353.50 €	22,241.50 €
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	102,030.00 €	83,655.00 €	84,900.00 €	1,245.00 €
	Lopë	233,820.00 €	198,475.00 €	174,420.00 €	-24,055.00 €
	Dhi	16,680.00 €	17,280.00 €	6,200.00 €	-11,080.00 €
	Dele	177,720.00 €	162,840.00 €	180,650.00 €	17,810.00 €
	Pula	37,150.00 €	21,680.00 €	27,339.66 €	5,659.66 €
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA		7,420.00 €	6,534.00 €	7,429.50 €	895.50 €
Perime ne Serra		7,420.00 €	7,260.00 €	21,931.04 €	14,671.04 €
Gjithsej		4,407,351.60 €	3,720,626.09 €	5,423,440.68 €	1,765,979.05 €

Të dhënat e kësaj table tregojnë për vlerën monetare që fermerët e komunës sonë do të marrin nga programi i pagesave direkte për vitin 2022.

Për dallim nga viti i kaluar këtë vit pritet që të kemi rritje të shumës së përgjithshme prej 1,765,979€. Sektori që ka ndikuar në këtë rritje është në sektorin e lavërtarisë ku krahasuar me vitin e kaluar këtë vit fermerët kultivues të drithërave do të përfitojnë mbi 1,000,000€ më shumë e poashtu edhe sektori i vreshtarisë do të ketë rritje rreth 500,000€.

Diferencën negative mund ta vërejmë te sektori i verëtarisë, ku krahasuar me vitin e kaluar vertarët e Rahovecit do të përfitojnë 56,574€ më pak. Përjashtim nuk bënë edhe sektori i blegtorisë ku duke u bazuar në këtë tabelë vërejmë vlerat negative.

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE

Në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Rahovecit janë duke u zbatuar një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale që kanë ndikim në përmirësimin e kushteve të bujqëve si në infrastrukturë publike (kanale të Kullimit, Rrugë fushore etj) dhe në përkrahje direkte për bujq (Mekanizëm Bujqësor, ndërtimi i serrave, ndërtimi i komoreve).

Mekanizëm Bujqësor

Komuna e Rahovecit si Autoritet Kontraktues me datë: 22.03.2022 ka nënshkruar kontratat me OE të ndarë në LOT-e, në Tenderët për furnizim me Mekanizëm Bujqësor në Komunën e Rahovecit.


Nga data 30.03.2022 kemi filluar të nënshkruajmë kontratat me secilin fermer përfitues, pasi që ai paraprakisht e ka kryer edhe pjesën e pagesës prej 20% të vlerës së pajisjes. Fillimisht janë kryer participimet e fermerëve përfitues nga viti 2020.

Me datë 06.04.2022 kemi filluar me shpërndarjen e pajisjeve bujqësore të fermerët përfitues varësisht se si Operatorët Ekonomik po arrijnë ta furnizojnë komunën e Rahovecit.

Tabela 3. Llojet dhe data e pajisjeve bujqësore të shpërndara të fermerët

Data e shpërndarjes	Përshkrimi i mekanizmit përfitues	Numri i fermerëve
06.04.2022	Motokultivator	300
22.04.2022	Makine mbjellëse pneumatike	10
	Plugjë dy Krahësh	7
	Motokultivator	20
16.06.2022	Centrifugë për mjaltë	22
	Shkrirëse dylli me avull	16

Foto gjatë shpërndarjes së pajisjeve bujqësore



Ne, jemi në pritje të konfirmimit për furnizim edhe me pajisjet e tjera që do të shpërndahen te fermerët përfitues. Prej shkurtit të këtij viti edhe Operatorët Ekonomik po hasin në vështirësi me furnizim si rezultat i rritjes së çmimeve.

Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Rrugëve Fushore


Në projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore, është duke u punuar në LOT 2 në vendbanimet Kramovik, Dobidol, Çifllak, Bratotinë, Vrajakë.

Në Lot 4 kemi intervenuar në disa pozicione nëpër vendbanime të komunës sonë si në Senoc, Krushë e Madhe, Rahovec, ndërsa Lot 1 dhe Lot 3 nuk janë zhvilluar punime si rezultat i rritjes së çmimeve nga fillimi i këtij viti.



Ndërtimi i Kanaleve të Kullimit të Tokave Bujqësore

Projekti i “Kanalet e Kullimit të Tokave Bujqësore” poashtu përshkak të kushteve klimatike jo të përshtatshme nuk është punuar, pasi që në këtë periudhë të vitit prurjet e ujit janë shumë të mëdha dhe implementimi i këtyre projekteve është i vështir. Gjatë muajit qershor kanë rifilluar punimet në ndërtimin e kanalit të kullimit të tokave bujqësore nga Shtavica deri në Fortesë si dhe në projektin e Kanalit të kullimit në fshatin Ratkoc.



Jemi në pritje të pëlqimit nga Ministria e Infrastrukturës për lejimin e ndërhyrjes në rrugën magjistrale R- 111 Xërxë-Kramovik, konkretisht në fshatin Çifllak pasi që paraprakisht kemi paraqitur kërkesën në këtë Ministri.

PËRFUNDIM

Jemi munduar të paraqesim thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që thirrja për aplikim është hapur me 26 prill dhe ka qenë e hapur për 30 ditë kalendarike dhe për këtë arsye kemi mospërmbushje të planit të punës me raportin për këtë periudhë.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijmë në thirrjet për aplikim që do të hapen në të ardhmen.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçantë inxhinier të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

21.06.2022

Rahovec

DREJTORI I DBPZHR-së

Berat Duraku

Shtojca 1. Tabela me të dhënat specifike për secilën kulturë

Të dhënat e fermerëve			2020	2021	2022	Diferenca
Sektori I Lavërtarisë		Nj. Matëse	Sip. në ha	Sip në ha	Sip në ha	Sip. në ha
1	Grurë	ha	1929.14	1,041.66	2,006.21	964.55
2	Misër	ha	1602.7	901.83	1,578.94	677.11
3	Elb	ha	2.61	12.64	4.05	-8.59
4	Tersher	ha	48.93	63.68	122.04	58.36
5	Theker	ha	2.62	0.00	0.00	0.00
Gjithsej			3,586.00	2,019.81	3,711.24	1,691.43
Sektori I Vreshtarise			Sip ne ha	Sip ne ha	Sip ne ha	
1	Lloji I kulturës					
2	Rrush		2,406.61	2,342.53	2,322.21	-20.32
3	Fidane të hardhisë		148,000.00	248,000.00	149,900.00	-98,100.00
Sektori I Perimkultures			Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Specat	ha	830.46	657.83	695.30	37.47
2	Domate	ha	19.07	7.43	11.48	4.05
3	Qepë	ha	188.90	191.89	149.76	-42.13
4	Hudhër	ha	33.47	21.08	25.56	4.48
5	Patate	ha	227.87	126.46	166.35	39.89
6	Tranguj	ha	10.43	1.55	0.43	-1.12
7	Karota	ha	11.50	9.83	7.65	-2.18
8	Rrepkë	ha	0.50	0.00	0.00	0.00
9	Brokuli	ha	0.00	0.40	0.25	-0.15
10	Fasule	ha	1.55	0.21	0.46	0.25
11	Pangjar	ha	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	ha	99.43	86.07	144.20	58.13
13	Lulelakër	ha	9.77	8.61	10.82	2.21
14	Presh	ha	4.21	0.00	0.20	0.20
15	Spinaq	ha	0.22	0.87	0.84	-0.03
16	Marule	ha	1.26	1.71	0.64	-1.07
Gjithsej			1,438.64	1,113.94	1,213.94	100.00
Kungullore			Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Shalqinj	ha	205.36	178.04	164.68	-13.36
2	Pjepër	ha	57.61	52.62	100.24	47.62
3	Kunguj	ha	18.07	12.80	11.82	-0.98
4	kungull I Gjelbert	ha	319.46	214.39	302.84	88.45
Gjithsej			600.50	457.85	579.58	121.73
Sektori I Pemtarisë			Sip. ne ha	Sip. ne ha		
1	Dardhë	ha	6.58	7.43	6.63	-0.80

2	Dredhëz	ha	0.66	2.51	2.72	0.21
3	Kumbull	ha	40.65	38.69	54.86	16.17
4	Mollë	ha	10.01	8.15	8.96	0.81
5	Arra	ha	30.08	57.88	73.90	16.02
6	Lajthi	ha	4.94	9.90	10.77	0.87
7	Ftoj	ha	0.92	3.51	4.17	0.66
8	Mjeder	ha	1.01	0.71	0.53	-0.18
9	Pjeshkë	ha	1.07	1.50	2.69	1.19
Gjithsej			95.92	130.28	165.23	34.95
Sektori I Blegtorisë dhe shpezetarisë						
1	Bletë	copë	6,802.00	5,577.00	4,245.00	-1,332.00
2	Lopë	Krerë	2,598.00	2,335.00	1,938.00	-397.00
3	Dhi	Krerë	834.00	864.00	248.00	-616.00
4	Dele	Krerë	8,886.00	8,142.00	7,226.00	-916.00
5	Pula vojëse	copë	74,300.00	43,360.00	59,100.00	15,740.00
Nr.	Lloji I kulturës		Sip ne ha	Sip ne ha		
Bimë mjeksore aromatike BMA		ha	14.84	14.52	16.51	1.99
Perime ne Serra						
1	Perime	ha	16.50	18.70	24.26	5.56